



**DRAFT PROGRAMI PËR ZGJEDHJET  
VENDORE  
2021-2025**

**KOMUNA E GOSTIVARIT**

**ARBEN TARAVARI**

**ABSTRAKT**

Ngritja e cilësisë së jetesës së qytetarëve, sipas standardeve evropiane ka qenë dhe do të jetë synim i jonë si obligim ndaj besimit të marrë në katër vitet e kaluara dhe besimin tuaj që do ta kemi në katër vitet e ardhshme.

**Përgatiti:**  
**Imërlije Saliu**  
**Shkëlqim Veseli**

Draft konfidencial i përgatitur nga  
Aleanca për Shqiptarët

## **Përshëndetje!**

Të nderuar qytetarë të Komunës së Gostivarit, besimi juaj i dhënë për katër vitet e kaluara ka qenë nder dhe privilegj për mua si dhe motiv që mua personalisht më bën të jem në shërbimin tuaj duke u kujdesur që të kem parasysh çdo nevojë dhe të vazhdoj të kontribuoj në ngritjen e standardit jetësor bashkërisht me ekipin tim. Dashuria ndaj qytetit dhe sigurimi i një jetese me standarde evropiane për bashkëvendësit e mi janë prioriteti im edhe për katër vitet e ardhshme.

Të hartosh një program për katër vitet e ardhshme është e një rëndësie të jashtëzakonshme për qytetin e Gostivarit dhe administratën komunale, sepse si synim kemi transformimin e qytetit dhe ndërveprimin e qytetarëve tonë duke ju dhënë hapësirë dhe mundësi që gjithsecili të jep sugjerime, propozime me qëllim që vizioni jonë të jetë i ndërtuar bashkërisht me ju edhe për katër vitet e ardhshme me synim përfundimtar përmirësimin e jetëve tona të përditshme dhe qyteti jonë të jetë vendi që çdokush do ta kishte zgjedhur për të jetuar.

Për këtë arsye ne kemi nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse strategjike në politikën e zhvillimit ekonomik lokal bazuar në kompetencat e përcaktuara të komunës, andaj qytetarë të nderuar ju konsideroj si bashkëpunëtorët e mi më të mirë duke kontribuar që bashkërisht të ndërtojmë të ardhmen e qytetit tonë sepse përpara meje nuk ka të privilegjuar dhe të anatemuar, nuk do të ketë ndasi në aspekte religjioze e nacionale. Katër vitet e kaluara unë kam qenë njeri i gjithë qytetit tim dhe do të vazhdoj të jem po i njëjti edhe në mandatin e ardhshëm.

Sfidat me të cilat jemi përballur kanë qenë mjaftë të mëdha duke u rënduar edhe më shumë nga gjendja e pandemisë në mbarë botën, por që vendi jonë e përballon me vështirësi edhe më të mëdha, sfidat edhe nga sferat tjera si politike e ekonomike, por besoj fuqishëm se të gjitha këto do të tejkalohen bashkërisht me mbështetjen tuaj por edhe të institucioneve tjera relevante, andaj duke u kujdesur për ndërtimin e të tashmes besojmë fortë në ngritjen e së ardhmes!

Të nderuar qytetarë të Gostivarit më lejoni që në vazhdim t'ju prezantoj programin për zgjedhjet vendore 2021-2025.

Me respekt

I juaji,

Arben Taravari

Kryetar i komunës së Gostivarit

## **Pasqyrë e shkurtë mbi Komunën e Gostivarit**

Në komunën e Gostivarit në sipërfaqe prej 650 km<sup>2</sup> jetojnë 83.557 banorë. Komuna e Gostivarit rrethohet nga 33 fshatra. **Numri i popullsisë sipas PËRKATËSISË NACIONALE – Regjistrimi i vitit 2002, Komuna e Gostivarit ka** gjithsej 81042 banorë, shqiptar 54038 66.7%, maqedonas 15877 -19.6%, turq 7991- 9.8%, romë 2237- 3.8%, vllleh 15 -0.01%, serbë 160- 0.19%, boshnjakë 39 -0.04%. të tjerë 685 -0.84%. Struktura e moshës së popullsisë është e volitshme me 75,8% popullsi të moshës prej 15 deri më 64 vjeç, 14,8% prej 0 deri 14 vjeç, ndërsa 9,4% mbi 65 vjeç. Sipas strukturës gjinore, 49.9% e popullsisë janë gra, kurse 50.1% janë burra dhe e është e njëjtë me strukturën gjinore të Republikës së Maqedonisë.

## **PARATHËNIA**

Të ndërtosh parimet për punët që planifikohen për mandatin e ardhshëm është një nga përgjegjësitë më të mëdha që mund të merr çdo kandidat për kryetar komune bashkërisht me administratën komunale. Me shumë përgjegjësi dhe dinjitet përpara jush prezantojmë platformën zgjedhore me qëndrimet, idetë, planet dhe projektet e kandidatit për kryetar të Komunës së Gostivarit nga radhët e Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës, Dr. Arben Taravari.

Ky program ka për synim të informojë qytetarët e Gostivarit për parimet bazë të qeverisjes për mandatin e ardhshëm katër vjeçar, parime të cilat premtojmë se me shumë përgjegjshmëri do të respektohen dhe do të zbatohen si nga ana e kryetarit të komunës bashkë me Këshillin komunal si dy organe kryesore po ashtu nga administrata komunale dhe institucionet tjera relevante si ndërmarrjet publike, institucionet arsimore, me qëllimin e vetëm që të jemi sa më afër qytetarit dhe përmbushjen e nevojave të tyre për ngritjen e nivelit të standardit jetësor si në pjesët urbane po ashtu edhe ato rurale. Programi që prezantojmë përpara jush vjen si rezultat i njohjes së mirë të problemeve me të cilat ballafaqohet komuna jonë dhe për të cilat kemi planifikuar një sërë projektesh duke u këshilluar vazhdimisht me ekspert të çështjeve lokale të qytetit tonë, duke marrë për bazë mendimin e këshilltarëve komunal, sugjerimet e administratës komunale, por mbi të gjithë rëndësi e veçantë i është kushtuar nevojave të qytetarëve në çdo lagje dhe është marrë për bazë çdo mendim e sugjerim i tyre në këshillim të vazhdueshëm me zyrtarë të lartë e ekspertë të akademisë shkencore të Aleancës për shqiptarët me qëllimin e vetëm që të jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve pa mos bë ndasi etnike e religjioze.

Ky program bazohet në kompetencat e përcaktuara reale ligjore për pushtetin lokal dhe ka për bazë supozimin që shumë projekte do të realizohen në bashkëpunim me pushtetin qendror.

## VIZIONI

Transparenca dhe kyçja e qytetarëve në ndërtimin e jetës në Komunën e Gostivarit dhe transformimi i qytetit është një nga synimet tona prioritare sepse ne jemi ndryshe nga qeverisjet e subjekteve tjera politike dhe Komunën e Gostivarit e shohim si një shtëpi e përbashkët për të gjithë qytetarët ku me kontribut të përbashkët dëshirojmë ta kemi vend ideal për një jetesë me standarde evropiane.

Përfshirja e politikave të qytetarëve ishte noviteti jonë edhe gjatë mandatit të kaluar, të cilën do të vazhdojmë ta kemi prioritet edhe në të ardhmen me të vetmen arsye që lirshmëria që qytetarët patën si në administratën komunale por edhe mundësia që të kenë njohuri ku ti drejtojnë të gjithë hallet e tyre, theu bindjen se institucionet janë burokratike dhe se qasja në to është e vështirë. Nga ana tjetër ne si institucion duke i praktikuar këto politika jemi shumë më afër problematikave qytetare dhe do të vazhdojmë po me këtë qasje që qytetarët e Gostivarit të ndjehen si në shtëpinë e tyre dhe zgjidhja e problemeve për një jetesë ideale të jetë sa më e lehtë.

Me këtë program përmes të cilit synojmë transformimin e qytetit me anë të projekteve të parapara për katër vitet e ardhshme, po ashtu qëllim bazë kemi krijimin e sa më shumë mundësive për punësim dhe krijimin e mundësive dhe kushteve që të rinjtë tonë të mos kenë synim largimin nga vendi dhe të sigurojnë të ardhmen jashtë shtetit tonë sepse Gostivari është qyteti ku çdokush mund të ndërtoj Dinjitetin e tij! Për këtë arsye ne kemi njëri tjetrin si burimin më të madh të forcës.

Me këtë program që synon të ndryshojë konceptin e deritanishëm të politikës, duke dashur të sjellë më shumë bashkëpunim, më shumë punë, më shumë të ardhura, më shumë transparencë, jemi të sigurt që Gostivarin do ta kemi shtëpinë tonë të përbashkët ku do të mund të jetojmë me nder e krenari.

Malcom X në një nga fjalimet e tija shprehu që: “Ata që janë përgatitur dje për ditën e sotme, do të sundojnë me të nesërmen”, duke dashtë që ardhmëria jonë të jenë të rinjtë ku me punë konkrete, vendimet që do të merren bashkë me qytetarët, do të bëjnë që bashkërisht të marrim në duar të ardhmen e fëmijëve tanë që e nesërmja tu përkas atyre duke u munduar që të gjithë bashkërisht të kemi në zemër qytetin tonë.

## **Qëllimet Kryesore**

Qëllimet që do të radhisim para jush, janë premtime për realizimin e të cilëve zotohemi, duke bashkëpunuar me ju qytetarë të nderuar, institucionet relevante, sektorin joqeveritar, sektorin e bizneseve si dhe një pjesë të tyre në bashkëpunim me pushtetin qendror si rezultat i kompetencave të përcaktuara me ligje.

- Pjesëmarrja e qytetarëve në projektet dhe aksionet e ndryshme për Komunën e Gostivarit.
- Qasja transparente ndaj të gjitha punëve komunale dhe ofrimi i shërbimeve transparente online për të gjithë kategoritë e qytetarëve.
- Vazhdimi i strategjisë për kujdesin dhe mirëmbajtjen arkitektonike të shkollave fillore dhe të mesme, dhe krijimin e shkollave me kushte evropiane.
- Kushte optimale shëndetësore për të gjithë territorin e komunës së Gostivarit.
- Krijimin e kushteve optimale në qytet për rininë që mundësitë për punësim dhe ndërtim të një ardhmërie t'i gjejnë në qytetin e Gostivarit.
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me sektorin e bizneseve private dhe krijimin e kushteve dhe klimës së përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të tyre,
- Tërheqjen e investimeve dhe shpërndarjen e tyre në të gjitha zonat ekuivalente si urbane ashtu edhe rurale në Komunën e Gostivarit.
- Investime në Agrikulturë.
- Krijimin e kushteve të volitshme dhe investime në Mjeshtëritë artizanale.
- Plan urbanistik për të gjithë vendbanimet rurale përpos atyre urbane.
- Tërheqja e bizneseve të huaja duke krijuar kushte dhe mundësi të volitshme për investitorët e jashtëm.
- Mbështetje maksimale e artit dhe kulturës si dhe mbështetjeje e artistëve të qytetit.
- Promovim i artistëve tanë brenda dhe jashtë qytetit.
- Zhvillimi i turizmit dhe promovimi i të gjitha pikave turistike të qytetit me qëllim të tërheqjes së turistëve si të vendit por edhe të huaj në qytetin tonë.
- Krijimi i kushteve dhe mundësive për sporte kolektive me qëllim të angazhimit më të lartë të rinisë sonë në sporte të ndryshme.

- Krijimi i të gjitha kushteve të favorshëm dhe mundësive për Personat me aftësi ndryshe si dhe kyçja e tyre në të gjitha sferat e jetës.
- Mbështetje dhe ndihmesë e vazhdueshme për të moshuarit.
- Rritje e pjesëmarrjes së gjinisë femërore në pozita udhëheqëse si dhe rritje e barazisë gjinore në të gjitha organet dhe institucionet nën qeverisjen e pushtetit lokal në Gostivar.
- Bashkëpunim i plotë dhe transparent me sektorin civil, organizatat joqeveritare dhe mediat.

## **PËRMBAJTJA**

- **FJALIMI PËRSHËNDETËS**
- **PARATHËNIE**
- **VIZIONI**
- **QËLLIMET KRYESORE**
- **PARIMET E QEVERISJES**
- **DECENTRALIZIMI FUNKSIONAL PËR ZHVILLIM TË BARABARTË**
- **DECENTRALIZIMI FISKAL FUNKSIONAL**
- **ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL**

## **AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE TË VETËQEVERISJES LOKALE**

---

### **1.KOMUNA E QEVERISUR MIRË DHE ME DEMOKRACI PJESËMARRËSE QEVERISJA E MIRË DHE TRANSPARENCA DECENTRALIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL DEMOKRACIA PJESËMARRËSE**

### **2. ORGANET DHE ADMINISTRATA KOMUNALE EFIKASE, BASHKËKOHORE DHE NË SHËRBIM TË QYTETARËVE**

**SHËRBIME KOMUNALE CILËSORE PËR TË GJITHË  
TRANSFORMIMI DIGJITAL  
SIGURI NË ÇDO CEP TË KOMUNËS**

### **3.KOMUNA E MIRËQENIES PËR TË GJITHË MBROJTJA E NATYRËS DHE E MJEDISIT JETËSOR SHËNDETËSIA ARSIMI MBROJTJA SOCIALE DHE POLITIKAT INKLUZIVE KULTURA SPORTI**

### **4.KOMUNA ME ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM LOKAL ZHVILLIMI I EKONOMISË LOKALE DHE I PUNËSIMIT TURIZIMI**

**5.KOMUNA ME REND DHE PLAN NË ÇDO LAGJE  
PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL  
MOBILITETI  
BANIMI I QËNDRUESHËM DHE I PËRBALLUESHËM  
10-të TOP PROJEKTET PËR KOMUNËN E GOSTIVARIT - 2021-2025.  
INFRASTRUKTURA**

**6.BIOGRAFIA**

**Parimet e qeverisjes**

Bazuar në kompetencat e Komunës së Gostivarit të përcaktuara nga Ligji për vetëqeverisje lokale, komuna do të punojë në pajtueshmëri me parimet e qeverisjes së mirëfilltë të dhëna nga Komisioni ekonomik dhe social i organizatës së Kombeve të Bashkuara, që do ti kemi si standard në përditshmërinë e veprimit tonë institucional.

**Pjesëmarrja**

Me pjesëmarrje nënkuptojmë pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje për çështje të rëndësishme të ngritjes së standardit jetësor, qoftë në formë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve si dhe institucioneve relevante legjitime.

**Sundimi i ligjit**

Sundimi i ligjit dhe respektimi me përpikëri i dispozitave ligjore, mbrojtja e plotë e të drejtave të njeriut dhe të gjitha pakicave, do të jenë nga parimet të cilat do ti kemi në prioritet në përditshmërinë e punës sonë.

**Transparenca**

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me qytetarët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre duke marrë për bazë çdo ide sugjerim, mendim nga ana e tyre, organizimi i forumeve qytetare për projekte konkrete, organizimi i debateve publike, thirrjeve publike për shqyrtimin e planeve dhe programeve komunale si dhe informimi i vazhdueshëm për punët tona nëpërmjet mediave sociale si dhe ueb-faqes zyrtare të komunës, janë metoda për qasje transparente ndaj qytetarëve.

**Partneriteti me bizneset**

Krijimi i kushteve dhe klimës së favorshme për bizneset dhe veprimtaritë e tyre, nxitja, inicimi dhe mbështetja e vazhdueshme, janë një nga synimet tona për partneritet me bizneset.

**Orientim drejt konsensusit politik**

Konsensusi politik është parim kryesor që për qëllim ka që qytetarët të kenë trajtim të barabartë institucional pavarësisht bindjeve të tyre partiake dhe ky parim do të udhëheq çdo veprim tonin.

**Barazia dhe përfshirja**

Përfshirje në optimalen e mundshme e të gjithë grupeve të marginalizuara në të gjithë sektorët

operativ.

### **Efikasiteti**

Efikasiteti jonë institucional do të jetë në mbrojtjen e vazhdueshme të burimeve natyrore dhe mjedisit si dhe arritjen e rezultateve sa më të shumta me mjetet të cilat institucioni jonë ka në dispozicion.

### **Përgjegjësia ndaj qytetarëve**

Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë synim në çdo punë që ne kemi si vizion për të ardhmen tonë duke u përpjekur që të jemi të barabartë dhe të paanshëm për të gjithë, andaj rëndësi të veçantë kanë edhe kërkesat e pakicave dhe grupeve të marginalizuara.

Përgjegjësia jonë do të jetë edhe lufta e vazhdueshme ndaj minimizimit të korrupsionit dhe toleranca zero ndaj kësaj dukurie.

### **Decentralizimi fiskal funksional për zhvillim të barabartë**

Ne besojmë se decentralizimi dhe fuqizimi i mëtejshëm i komunës së Gostivarit dhe komunave tjera varet në masë të madhe edhe nga politikat dhe infrastruktura rregullatore në nivelin qendror. Ne do të vazhdojmë të ndjekim dhe të shtyjmë disa prioritete horizontale të identifikuar në programin tonë qendror: “Shtet për të Gjithë 2020-2024”. Këto prioritete kanë të bëjnë me parakushtet themelore për një vetëqeverisje lokale efikase, efiçiente dhe në shërbim të interesit dhe nevojave të qytetarëve në nivelin lokal, me synim të ofrimit të një shërbimi cilësor dhe të barabartë për të gjithë.

Ndërtimi i një sistemi demokratik është i lidhur ngushtë me procesin e decentralizimit. Sa më i decentralizuar të jetë pushteti, aq më demokratik është vendi dhe qytetarët janë më aktiv në vendimmarrje.

Në parim, së paku 1% e prodhimit bruto vendor (PBV) duhet të alokohet për zhvillim rajonal përmes buxhetit të shtetit. Këto fonde duhet t'u shpërndahen rajoneve planore në bazë të çelësit shpërndarës në vijim: 70% e fondeve duhet të përdoren për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore, 20% për financimin e projekteve për zhvillimin e zonave me nevoja specifike zhvillimore, dhe 10% për financimin e projekteve për zhvillim rural.

Megjithatë, edhe përkundër rritjes së investimeve për zhvillim të barabartë rajonal gjatë viteve të fundit, arritja e caktit të 1% të PBV-së mbetet ende shumë larg dhe detyrimi ligjor nuk zbatohet: vetëm 452,88 milion denarë, apo rreth 7,36 milion euro, janë ndarë në buxhetin e vitit 2021, dhe 479,5 milion denarë, apo 7,8 milionë euro, janë planifikuar në buxhetin e vitit 2022.

Kjo, natyrshëm, ndikon drejtpërdrejtë në forcimin e mëtuqjeshëm të pabarazisë në zhvillimin rajonal dhe vazhdimin e logjikës shfrytëzuese përmes një rishpërndarje të padrejtë.

Sa i përket raportit ndërmjet të ardhurave të vetëqeverisjes lokale dhe të ardhurave të përgjithshme publike, Maqedonia e Veriut është nën mesataren e rajonit dhe atë evropiane, me vetëm 15,7%, krahasuar me 17,3% në Evropën juglindore dhe 23,5% në BE. Të ardhurat e përgjithshme të komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vetëm 4.9% e PBV-së, krahasuar me 6,0% në Evropën juglindore dhe 10,7% në vendet e BE-së (NALAS, 2020).

### **Kjo pabarazi ka burimin në Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes**



## **lokale i cili përcakton se:**

- janë disa lloje të të ardhurave tatimore në nivelin lokal: 1) tatimi në pronë; 2) tatimet e trashëgimisë dhe dhuratave; 3) tatimi për transferimin e pasurive të paluajtshme; dhe 4) çdo taksë tjetër e paraparë me ligj. Të tre tatimet që janë të hyrat vetjake të komunës rregullohen me Ligjin për tatimin në pronë (2004).
- komuna merr 3% të tatimit mbi të ardhurat personale të banorëve të përhershëm ose të përkohshëm në territorin e saj dhe 100% të tatimit mbi të ardhurat e zejtarëve në territorin e komunës.
- Ligji për buxhet përcakton pjesëmarrjen e komunave në të ardhurat nga TVSH-ja, grande për qëllime specifike, grande kapitale, donacione të kapitalit dhe grande për detyra të transferuara.

Në praktikë, struktura e të ardhurave të vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut vuan nga një pa baraspeshë e theksuar në favor të donacioneve të kapitalit (të njohura ndryshe si bllok dotacionet), të cilat përbëjnë 51% të të ardhurave të komunave. Të hyrat vetjake kontribuojnë rreth 34% në të ardhurat e përgjithshme komunale, pasuar nga tatimet tjera me 7%, donacionet e përgjithshme me 4% dhe donacionet për investime kapitale me 3%.

Mesatarja e Ballkanit Perëndimor sa u përket të hyrave vetjake qëndron në 39%, pasuar nga donacionet e përgjithshme me 21%, donacionet e kapitalit me 18%, tatimet tjera me 14% dhe donacionet për investime me 7% (NALAS, 2020).

Donacionet e kapitalit përcaktohen nga qeveria dhe përdoren për financimin e projekteve të infrastrukturës, e jo për të siguruar funksionimin e përgjithshëm dhe përmbushjen e mandatit të komunave. Këto grande menaxhohen nga ministritë dhe fondet e ndryshme shtetërore, të cilat shpeshherë ndikohen nga interesat politike dhe janë të autorizuar të ndalojnë pagesën e grandeve nëse ka ndonjë parregullsi të raportuar ose vërejtje. Donacionet e kapitalit gjithashtu caktohen dhe jepen në përputhje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale për programe specifike.

Ky model i decentralizimit ka krijuar pabarazi shumë të madhe ndërmjet komunave sipas kriterit të të ardhurave për kokë banori. Si pasojë, komunat tona, përfshirë këtu edhe komunën e Gostivarit janë të nën financuara në krahasim me vendet e BE-së dhe ato të Ballkanit Perëndimor, ato janë të zhytura në borxhe gjithnjë në rritje, dhe si pasojë, një gamë e gjerë e kompetencave të transferuara nuk kanë mbulesë të mjaftueshme financiare.

Komunat tona shpenzojnë mesatarisht vetëm 282 euro në vit për kokë banori, krahasuar me 500 euro në Evropën Juglindore. Shpenzimet e vetëqeverisjes lokale janë vetëm 4,9% e PBV-së dhe 16,1% e shpenzimeve publike, ndërsa në vendet e rajonit mesatarja është 6,9% e PBV-së, kurse në vendet e OECD-së vetëqeverisja lokale shpenzon mesatarisht 9,2% të PBV-së dhe 28,7% të shpenzimeve të përgjithshme publike (NALAS, 2020).

Më të dëmtuarit nga ky realitet natyrshëm janë qytetarët, të cilët nuk gëzojnë shërbimet të cilat u takojnë me Kushtetutë dhe me ligj. Ky problem është edhe më i theksuar në komunat e vogla dhe ato rurale, të cilat janë edhe më të diskriminuara pasi që standardi i njëjtë i shërbimeve publike duhet të sigurohet me buxhete shumëfish më të vogla për kokë banori.

Anashkalimi i interesave të qytetarëve dhe vazhdimi i diskriminimit në baza etnike dhe rajonale, mund të shkaktojë kriza të reja për vendin. E kaluara dhe e tanishmja imponojnë reforma të domosdoshme, pasi që për vite me radhë institucionet qendrore kanë dëshmuar se nuk kanë gatishmëri t'i tejkalojnë preferencat politike dhe të përballen me nevojat e qytetarëve.

Andaj, Aleanca për Shqiptarët do të vazhdojë të angazhohet për një model të mirëfilltë decentralizimi, që mundëson vetëqeverisje lokale efikase dhe eficiente, e cila plotëson nevojat e qytetarëve dhe i jep fund politikës së shantazhit dhe të kushtëzimit të komunave nga niveli qendror përmes sistemit të donacioneve të kapitalit.

Synimi ynë kryesor është që të ardhurat e komunave nga 15,7% sa janë tani, të arrijnë në 30% të të ardhurave të përgjithshme publike, duke mundësuar autonomi fiskale të qëndrueshme për vetëqeverisjen lokale. Për arritjen e këtij synimi, do të angazhohemi për prioritetet në vijim.

✓ **Model i decentralizimit funksional.** Ky model decentralizimi e lidhë bartjen e kompetencave me ekzistimin e institucioneve në sektorë përkatës. Për shkak të de investimit historik në rajonet veri perëndimore, ballafaqohemi me mungesë të institucioneve gjegjëse. Kjo pamundëson alokimin e mjeteve nga donacionet e kapitalit qeveritare në nivelin lokal, që është formë e padrejtë financimi dhe burim diskriminimi.

Kalimi në modelin funksional ku subvencionet janë të përgjithshme dhe synojnë rritjen e kapacitetit të përgjithshëm të komunave për të përmbushur misionin e tyre ligjor, mundëson financimin e nevojave të qytetarëve dhe jo të objekteve.

✓ **Fondi komunal.** Krijimi i fondit komunal, i bazuar në përvojat evropiane, do të mundësojë donacione të përgjithshme, pa asnjë alokim drejt ndonjë misioni apo projekti specifik. Qëllimi kryesor është që t'u mundësohet komunave (Komunës së Gostivarit) të përmbushin mandatin e tyre të përgjithshëm sipas kompetencave të tyre ligjore. Fondi i komunave do të shfrytëzohet gjithashtu për situata të jashtëzakonshme, si për shembull vërshimet dhe katastrofat tjera natyrore. Ky fond to të mund të financohet përmes ndryshimit të formulës për shpërndarjen e TVSh-së dhe rritjes së përqindjes së TVSh-së që u kthehet komunave nga 4,5% në 10%. Në komunat ku pasuritë natyrore menaxhohen nga pushteti qendror, do të caktohet përqindja e të ardhurave që u kthehen komunave, në raportin 80% për nivelin lokal, 20% për nivelin qendror.

✓ **Miratimi i Planit për revitalizimin e vendbanimeve prej 500 milionë eurosh do ta përmirësojë standardin jetësor dhe mirëqenien e qytetarëve.** Me këtë iniciativë do të hartohet një program i investimeve publike për nevojat elementare jetësore, si ujë për pije, kanalizim, asfaltim dhe ndriçim të vendbanimeve. Me këtë do të mundësojmë kushte më të mira dhe standard normal jetësor. Ky plan do të realizohet nga ndërmarrjet vendore, me çka do të stimulohet edhe punësimi.

✓ **Krijimi i një institucioni financiar qeveritar për kreditimin e komunave me kushte të volitshme (norma e interesit 1%),** që do të shërbente si mbikëqyrës i financave komunale, por edhe si burim i financimit të komunave. Huamarrjet e komunave do të jenë të kushtëzuara vetëm për investime kapitale lokale.

✓ **Rritja e kompetencave të komunave në menaxhimin e pasurive natyrore,** si uji, pyjet dhe minierat. Do të bëhet ndarja e të ardhurave ndërmjet pushtetit lokal dhe atij qendror

në raportin 80/20 në favor të komunave.

Më pas, për realizimin e plotë të synimeve të lartpërmendura, do të angazhohemi edhe në përmirësimin e cilësisë së kompetencës, transparencës dhe qasjes në politikat fiskale buxhetore të qytetarëve në **Komunën e Gostivarit**, edhe atë:

- ✓ Transparencë dhe informim të qytetarëve për mungesën e qartësisë lidhur me shpërndarjen e përgjegjësiave mes autoriteteve komunale dhe qeveritare nëpërmjet mekanizmave informative-mediatike
- ✓ Transparencë dhe bashkë vendosje me qytetarët për hartimin e Planeve për shlyerjen e borxheve eventuale
- ✓ Ngritja e kapaciteteve të personelit për informim në kohë të duhur për gjendjen dhe kapacitetin buxhetor
- ✓ Kalendar buxhetor me qasje me pjesëmarrje në buxhetimin (përfshirë qytetarët)
- ✓ Buxhetet komunale me transparencë ju prezantohen qytetarëve:
  - Orari i rregullt në zyrë për qytetarët
  - Nëpërmjet Qendrave informative për qytetarët
  - Prezantimet në mbledhjen e qytetarëve
  - Mediat lokale
- ✓ Transparenca informative-mediatike për Administrimin me tatimet dhe huazimet komunale
- ✓ Transparenca informative-mediatike për Sistemin e Kontrollit dhe Revizionit të brendshëm
- ✓ Plotësimin e nevojave për ndërtimin e kapaciteteve në sferën fiskale

### **Zhvillimi i barabartë rajonal**

Pabarazitë financiare dhe fiskale në politikat zhvillimore janë shumë të larta në Maqedoninë e Veriut, dhe ato e kanë thelluar hendekun midis komunave rurale dhe atyre urbane, por edhe midis rajoneve planore. Rajonet siç janë ai Jugperëndimor, Verilindor dhe Pollogu, ngecin dukshëm në krahasim me rajonet tjera si pasojë e de investimit nga pushteti qendror dhe e nën financimit të institucioneve të vetëqeverisjes lokale.

Rajoni i Pollogut mbetet më i diskriminuar në fushën e investimeve kapitale me 1.032 denarë për kokë banori, krahasuar me 1.693 denarë në rajonin Juglindor apo 1.947 në rajonin e Vardarit. Në rajonin e Shkupit, realizohen 65% më shumë investime kapitale për kokë banori në krahasim me nivelin mesatar të realizuar në Maqedoninë e Veriut dhe 356% më shumë se në rajonin e Pollogut.

Diskriminimi është po ashtu i theksuar përbrenda rajoneve. Kështu, në rajonin e Shkupit,

investimet për kokë banori në komunën urbane të Qendrës janë prej 5.309 denarësh, krahasuar me vetëm 85 denarë për kokë banori në komunën e Haraçinës.

Këto të dhëna dëshmojnë thellimin e pabarazisë si rezultat i politikave diskriminuese të zbatuara nga niveli qendror, që vijnë si pasojë e mosrespektimit të Ligjit për zhvillim të barabartë rajonal. Kjo, natyrshëm, ndikon drejtpërdrejtë në forcimin e mëtutjeshëm të pabarazisë në zhvillimin lokal dhe rajonal dhe vazhdimin e logjikës shfrytëzuese. Këtë argument e forcojnë edhe mjetet e ndara në vitin 2020 për zhvillim të barabartë rajonal prej vetëm 7,35 milionë eurosh, edhe përkundër detyrimit ligjor prej 1% të PBV-së.

Andaj, në funksion të ndaljes së diskriminimit të mëtejshëm dhe nxitjes së zhvillimit të barabartë ekonomik të rajoneve planore, Aleanca për Shqiptarët vazhdon të angazhohet për prioritetet në vijim.

✓ **Shndërrimi i rajoneve planore në Qendra të Avancuara Administrative**, në mënyrë që pasqyrimi dhe shtrirja e të gjitha niveleve të pushtetit ekzekutiv (ministri, ndërmarrje publike, agjenci, drejtori, shoqëri aksionare) dhe gjyqësor (gjykata dhe prokurori të apelit) do të bëhet sipas modelit të rajoneve e jo sipas modelit aktual që shkakton çekuilibrim dhe diskriminim.

✓ **Zhvillimi i barabartë i zonave ekonomike, si në përkrahje financiare të shtetit për ndërtimin e infrastrukturës, ashtu edhe në shpërndarjen e investitorëve.** Nevojitet status i veçantë për zonën e Vizbegut, përmes centralizimit të kompetencave urbanistike dhe infrastrukture në një institucion shtetëror. Përveç kësaj, duhet të bëhet edhe barazimi ligjor dhe investues i zonave të lira ekonomike të Vizbegut, Strugës, Kërçovës, Tetovës dhe Likovës me zonat e tjera ekonomike, siç janë investimet në infrastrukturën rrugore, elektrike, kanalizimin dhe ujësjellësin.

### **Avancimi i kornizës ligjore të vetëqeverisjes lokale**

Agjenda legislative e Aleancës për Shqiptarët në nivel qendror, me qëllim të forcimit të rritjes së subsidiaritetit dhe kapacitetit të komunave për të përmbushur misionin e tyre, do të përfshijë masat në vijim:

✓ **Avancimi i kornizës ligjore për emërimet nga ana e këshillave komunal në institucionet kulturore dhe të trashëgimisë si dhe në kuadër të policisë**, në mënyrë që emërimi i drejtorëve të teatrove dhe institucioneve tjera kulturore të qytetit, por edhe i krye-shefave të stacioneve policore, udhëheqësve të krim-teknikës si dhe pozitave udhëheqëse të administratës policore të jenë kompetencë komunale.

✓ **Rivlerësimi i organizimit të gjykatave themelore dhe të apelit në bazë të rajoneve planore**, me synim të rritjes së efikasitetit, afërsisë me qytetarin, përfaqësimit dhe të besueshmërisë, si dhe të uljes së ndërhyrjeve politike.

✓ **Transferimi i mbrojtjes sociale në kompetencën e vetëqeverisjes lokale.**

### **Komuna e qeverisur mirë dhe me demokraci pjesëmarrëse**

Mbrojtja e interesit të përgjithshëm, përballja e pikëpamjeve dhe bindjeve, mbrojtja dhe promovimi i komunës si dhe kontributi në jetën shoqërore janë parimet kryesore të angazhimit

tonë politik në baza ditore, parime të cilat Komuna e Gostivarit me përpikëri i ka praktikuar edhe në këtë mandat katër vjeçar.

Puna e përfaqësuesve tonë lokal është jetike për vitalitetin e demokracisë. Ata janë në vijën e parë për të ngritur shqetësimet e qytetarëve pranë nivelit politik dhe rezultatet e punës së tyre janë gjithashtu më të prekshme në jetën e përditshme të qytetarëve. Shumica dërrmuese e zyrtarëve të zgjedhur komunal, gra dhe burra të angazhuar politikisht, por që politikën nuk e kanë profesion, e kryejnë këtë detyrë me integritet, ndërgjegje dhe kompetencë, shpesh në dëm të kohës së tyre të lirë, jetës familjare apo profesionit të tyre.

Aleanca për Shqiptarët gjithmonë ka konsideruar si urgjente rikthimin e besimit të qytetarëve ndaj politikës, në veçanti në komunë, si niveli më i afërt me brengat e përditshme të qytetarëve. Andaj, të gjitha propozimet tona kanë për qëllim avancimin e qeverisjes së mirë dhe etikës në politikë, si dhe mbrojtjen e interesit të përgjithshëm mbi atë individual dhe partiak, për t'i mundësuar secilit qytetar dhe secilës qytetare më tepër mirëqenie dhe më tepër përfshirje aktive në jetën politike të komunës, gjë të cilën e kemi dëshmuar tash më në qeverisjen tonë katër vjeçare në komunën Gostivarit ku çdo qytetar me shumë lirshmëri ka pasur qasje në institucionet publike dhe do të vazhdojmë në ngritjen dhe rikthimin e besimit të qytetarëve edhe në mandatin e ardhshëm. Aleanca për Shqiptarët i jep një rëndësi të veçantë komunës sepse fuqizimi i nivelit lokal është pjesë e ADN-së së partisë sonë.

**Ne si Aleancë për Shqiptarët në Komunën e Gostivarit në mandatin e kaluar vazhdimisht jemi angazhuar për transparencë, llogaridhënie, pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje, mbështetje të shoqërisë civile lokale, forcim të solidaritetit, qeverisje të mirë dhe me zero tolerancë ndaj korrupsionit, efikasitet dhe cilësi të shërbimeve komunale, si dhe promovim të projekteve inovative dhe të qëndrueshme për të bërë jetën komunale më dinamike.**

### **Qeverisja e mirë dhe transparenca**

Mbrojtja e interesit të përgjithshëm, ndershmëria dhe transparenca në ushtrimin e funksionit publik janë lajtmotivi apo orientimi thelbësor i partisë sonë. Aleanca për Shqiptarët është dëshmuar në qeverisje lokale si parti ku angazhimi i përfaqësuesve politik është bazuar në bindje dhe parime, dhe ku ka mbizotëruar interesi publik mbi ato individuale, duke siguruar kështu qeverisje të mirë dhe zhdukje të konflikteve të interesit dhe korrupsionit.

Komuna e Gostivarit ka dëshmuar kryerjen e funksioneve publike me ndershmëri dhe transparencë, fakte të vërtetuara edhe nga institucionet relevante hulumtuese të vendit një nga të cilat është edhe Qendra për analiza ekonomike (CEA) e cila tregon rritje të indeksit të transparencës buxhetore për periudhën fiskale 2020-2021 nga 5.67 në vitin 2017 në 12 pikë në vitin e fundit, duke e bërë të jetë nga komunat shqiptare më transparente krahasuar me komunat tjera si Kërçova me 8 pikë, Struga me 4 pikë, Tetova me 2 pikë e kështu me radhë.

Qeverisja lokale është laborator i demokracisë, që mundëson forcimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në debate të caktuara, madje edhe në qeverisje përmes mjeteve siç është buxheti pjesëmarrës, duke i bërë qytetarët përgjegjës dhe aktorë në adresimin e sfidave të jetës komunale.

Po ashtu, Komuna e Gostivarit ishte një nga shtatë komunat si NjVL ku nga gjithsej 81

komuna në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila organizoi debat publik mbi llogarinë përfundimtare të buxhetit (për vitin fiskal 2020-2021, burim i marrë nga Qendra për analiza ekonomike)

Organizimi i forumeve në bashkësi është një praktikë mjaftë demokratike e zbatuar në Komunën e Gostivarit që mundëson pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendosjen e projekteve prioritare për qytetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Një forum i tillë u organizua nga Komuna e Gostivarit dhe Agjencia zvicerane për zhvillim në kuadër të projektit për fuqizimin e këshillave komunale dhe në këtë forum nga qytetarët u përzgjedh projekti me inkluzion social për ndërtimin e qendrës rekreative sportive rreth lumit Vardar mbështetur dhe financuar nga UNDP, Agjencia zvicerane për zhvillim dhe Komuna e Gostivarit.

Aleanca për Shqiptarët nëpërmjet qeverisjes me komunën e Gostivarit ka treguar se është mjaftë këmbëngulëse sa i përket transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve andaj ka edhe propozime konkrete në këtë drejtim :

✓ **Transparencë të plotë për shpenzimet operative** (open data) të zyrës së kryetarit të komunës dhe drejtorëve të ndryshëm komunal, të ndërmarrjeve publike komunale, dhe atyre ndër-komunale, si dhe të organizatave tjera komunale. Ne si subjekt politik në Komunën e Gostivarit kemi dëshmuar transparencë maksimale duke publikuar ne ueb faqen zyrtare të komunës raport për O (zero) shpenzime zyrtare të kryetarit të Komunës së Gostivarit. Po ashtu hulumtimi i realizuar nga Open Finance një nga portalet më të besueshme të vendit e cila ka për detyrë informimin e opinionit publik mbi transaksionet buxhetore të pushtetit qendror dhe lokal vërteton se në Komuna e Gostivarit ka për 40% më pak shpenzime për shërbime telefonike për periudhën 2017-2021.

✓ **Zyra për auditim të brendshëm i raporton komitetit për auditim.** Kjo do të mundësojë transparencë më të madhe të shpenzimeve komunale dhe pavarësim të funksionit të auditimit të brendshëm nga kontrolli i politikës. Pavarësia e Komitetit për auditim do të arrihet duke zgjeruar anëtarësinë e Komitetit përtej autoriteteve komunale siç janë kryetari i komunës, sekretari i komunës apo udhëheqësi i divizionit të financave, për të përfshirë së paku një auditor të pavarur dhe të akredituar.

✓ **Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave vetjake, i menaxhimit të shëndoshë financiar, i planifikimit ekonomik dhe financiar dhe i shpërndarjes së burimeve.**

✓ **Kodi i etikës për të përfaqësuarit politik në nivel komunal,** i miratuar nga Këshilli komunal në fillim të mandatit, që përmban një sërë udhëzimesh dhe rregullash për moralizimin e jetës publike. Ky kod etik duhet të adresojë konfliktet e interesit, përdorimin e burimeve komunale, respektimin e procesit të vendimmarrjes dhe sanksionet.

✓ **Rekrutim transparent dhe objektiv i personelit komunal dhe të strukturave nën përgjegjësinë e komunave përmes softuerëve për burime njerëzore dhe përfshirjes së shoqërisë civile.** Objektivizmi i rekrutimeve në administratë, çerdhe, arsim, ndërmarrje publike, etj. do të sigurohet përmes komisioneve të paanshme për çdo rekrutim, në të cilat do të sigurohet pjesëmarrja e opozitës komunale dhe shoqërisë civile (shoqata të prindërve, OJQ, etj.). Do të ndalim përdorimin e tepërt të rekrutimeve të përkohshme, kontratave mbi vepër dhe llojet tjera të rekrutimit që e anashkalojnë parimin e meritës dhe forcojnë klientelizmin.

✓ **Rritja e transparencës së arsyeve të pushimit nga puna. Pushimit nga puna gjithashtu duhet t'i jepet më tepër përmbajtje për të siguruar drejtësi dhe proces të rregullt.**

✓ **Shkarkimi i menjëhershëm i zyrtarëve komunal ndaj të cilëve merret vendim gjyqësor i formës së prerë në çështje penale.**

✓ **Zhvillimi i ndërveprimit të ueb faqeve të komunës, përfshirë transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Këshillit komunal.** Gjithashtu do të sigurohet porositja në distancë të dokumenteve administrative komunale, qasja në dokumentet e mbledhjeve të Këshillit komunal dhe të takimeve tjera të hapura për qytetarët, përfshirë botimin e rendeve të ditës dhe procesverbaleve.

✓ **Zbatimi i përpiktë i ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe garantimi i të drejtave gjuhësore të qytetarëve.**

✓ **Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i komuniteteve që jetojnë në territorin e komunës, si dhe përfaqësim të ekuilibruar gjinor në organet komunale.**

## **Decentralizimi dhe bashkëpunimi ndër-komunal**

Aleanca për Shqiptarët gjatë qeverisjes në komunën e Gostivarit do të angazhohet për forcimin e strukturës institucionale lokale, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe të cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Dy akset kryesore dhe komplementare që do të ndjekim drejt këtij qëllimi janë: forcimi i rajoneve planore dhe rritja e bashkëpunimit mes tyre dhe komunave, avancimi i bashkëpunimit ndër-komunal.

### **Forcimi i rajoneve planore dhe rritja e bashkëpunimit mes tyre dhe komunave**

Në përputhje me Kartën evropiane për vetëqeverisje lokale, do të angazhohemi që subvencionet qeveritare për komunitat mos të jenë të destinuara për financimin e projekteve specifike, por të jenë të natyrës së përgjithshme dhe të mundësojnë lirinë e veprimit të autoriteteve lokale në fushën e tyre të kompetencës. Aleanca për Shqiptarët do të këmbëngul që autoriteteve lokale t'u garantohen burime njerëzore dhe buxhetore të nevojshme për përmbushjen e misioneve komunale të përcaktuara me ligj.

Aleanca për Shqiptarët vlerëson se është e domosdoshme që të përmirësohet përdorimi i burimeve publike dhe të forcohet efikasiteti dhe cilësia e shërbimeve publike të nivelit lokal, ndër tjera përmes racionalizimit dhe bashkimit të kostove përmes bashkëpunimit ndër-komunal. Bashkëpunimi i tillë mundëson ekonomi të shkallës dhe ulje të çmimit përfundimtar të shërbimit për xhepin e qytetarit. Ekonomitë e shkallës i referohen uljes së kostos së një malli apo shërbimi që vjen si pasojë e rritjes së nivelit (apo shkallës) të prodhimit. Sa më e madhe sasia e shërbimit të prodhuar, aq më e ulët është kostoja fikse për njësi. Kjo mund të arrihet

vetëm duke zhvilluar një qeverisje të re në nivelin lokal përmes bashkëpunimit ndër-komunal, që bashkon komnat, qytetet dhe viset rurale në një projekt të përbashkët, në koordinim me Qendrat për zhvillim të rajoneve.

### **Avancimi i bashkëpunimit ndër-komunal**

Bashkëpunimi rajonal mundësohet nga legjislacioni vendor por, fatkeqësisht, zbatimi i këtij modeli ka ngecur për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe të ekspertizës. Aleanca për Shqiptarët synon që të avancojë këtë model të dëshmuar në shumë vende të BE-së në ofrimin e shërbimeve më të afërta dhe më cilësore për qytetarin.

Do të krijojmë sinergji më të shpeshta dhe më të thelluara midis komunave dhe rajoneve planore, bazuar në modelin e bashkëpunimit ndër-komunal dhe të bashkëfinancimit të projekteve nga rajonet planore dhe komnat, me kujdes të veçantë për ruajtjen e interesit të secilës komunë pjesëmarrëse dhe mënjanimin të rreziqeve rreth zhytjes në borxhe të bashkëpunimeve të tilla me fajin e keq menaxhimit financiar nga ana e ndonjë komune pjesëmarrëse. Fushat tipike në të cilat do të zhvillohen projekte ndër-komunale janë shpërndarja e ujit të pijshëm, planifikimi hapësinor ose menaxhimi i mbeturinave përmes ndërmarrjeve ndër-komunale.

Në këtë drejtim, do të iniciojmë një debat dhe një reflektim në nivel republikan mbi zgjerimin e modelit të ndërmarrjeve komunale në të gjithë sektorët relevantë me karakter të shërbimit publik, në veçanti energjitë e ripërtëritshme, zhvillim ekonomik, financim të komunave, ruajtje të mjedisit, infrastrukturë dhe proceset arsimore, institucionet kulturore, etj.

### **Demokracia pjesëmarrëse**

Aleanca për Shqiptarët beson se demokracia pjesëmarrëse është plotësim i domosdoshëm i demokracisë përfaqësuese. Por që pjesëmarrja aktive e qytetarëve të jetësohet, komnat duhet të ndërmarrin iniciativa konkrete: shpërndarje të informacionit, organizim të një dialogu të përhershëm dhe krijim të një platforme për pjesëmarrjen qytetare.

Ne do të inkurajojmë demokracinë pjesëmarrëse, për të rritur interesimin e qytetarëve për çështjet publike, nxitur pjesëmarrjen e tyre në jetën e komunës dhe për të rritur ndikimin pozitiv të qytetarëve mbi përfaqësuesit e tyre të zgjedhur. Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet pjesëmarrës së të rinjve, si grup i marginalizuar në politikat publike. Mungesa e përfshirjes së të rinjve në hartimin e politikave publike rezulton me mosbesim të thellë të të rinjve në institucionet publike dhe në partitë politike.

**Në këtë rrafsh, propozimet tona janë:**

### **Informimi i qytetarëve**

Nuk mund të ketë pjesëmarrje qytetare pa qasje në informacion. Andaj, komuna e Gostivarit ka dëshmuar transparencë në katër vite qeverisje dhe zotohemi se do të vazhdojmë me rritjen e transparencës dhe sa më shumë që të jetë e mundur do të kontribuojmë në ofrimin e



informacioneve të qarta dhe objektive në lidhje me jetën politike komunale. Për ta arritur këtë synim ne si komunë do të përqendrohemi në prioritet në vijim.

- ✓ **Rritja e interaktivitetit të ueb faqes komunale, ndër tjera duke zbatuar masa të qeverisjes elektronike siç është porositja online e dokumenteve administrative dhe e certifikatave të ndryshme që janë përgjegjësi komunale.**
- ✓ **Publikimi dhe thjeshtëzimi i buxhetit komunal në një formë të qartë dhe vizuale. Transparenca e plotë duhet të bëhet në lidhje me përdorimin e fondeve komunale, që qytetarët të kuptojnë si shpenzohen tatimet e tyre dhe sa realizohen premtimet politike.**
- ✓ **Publikimi në ueb faqen komunale të regjistrimit të të gjitha organizatave (OJQ, shoqata, klube sportive, etj.) që marrin subvencione komunale.**
- ✓ **Sinjalizimi i qartë informativ pranë punishteve, ku sqarohet qëllimi i projektit, kohëzgjatje, kostoja, autoritetet përgjegjëse, përfshirë edhe ilustrime projektuese, dhe të dhënat kadastrale.**
- ✓ **Krijimi i një aplikacioni komunal për informim të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe ndërveprim në kohë reale me autoritetet komunale, për shembull, për të raportuar problemet e pastrimit ose parkimit.**

### **Rritja e pjesëmarrjes qytetare**

Pjesëmarrja aktive e qytetarëve konsiston në hapjen e mekanizmave të vendimmarrjes komunale për qytetarët. Disa mekanizma kryesore duhet të përdoren për të siguruar këtë pjesëmarrje:

- ✓ **Sistematizimi i kornizës ligjore për pjesëmarrjen qytetare, i cili do të zyrtarizojë procedurat informative dhe këshilluese për projekte në lidhje me mjedisin jetësor, urbanizimin, planifikimin hapësinor, etj. Për shembull, në fushën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit lokal ne si komunë kemi marrë sugjerimet e banorëve nga secili vendbanim urban e rural për nevojat e tyre, sugjerime të cilat i kemi pjesë të Programit zgjedhor për katër vitet e ardhshme.**
- ✓ **Sistematizimi i kornizës ligjore për menaxhim bashkëpunues. Do të krijohet një platformë online me qëllim zbatimin e politikave urbane, transformimin e hapësirës me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve. Kështu komunat do të kenë qasje të një qeverisje bashkëpunuese që përqendrohet dhe promovon konceptin bashkëkohor të zhvillimit hapësinor përmes platformës online, ku qytetari është i informuar në kohë reale nga njëra anë dhe nga ana tjetër, idetë, denoncimet dhe mendimet e qytetarit në kohë reale hynë në sistem dhe ndiqen në çdo hap të proceseve komunale.**
- ✓ **Qytetarët e Gostivarit kanë pasur dhe do të kenë mundësi të njoftohen me të gjitha dokumentet e projekteve të reja infrastrukturore, përfshirë makete projektuese, të cilat duhet të jenë të qasshme në një sallë të hapur dhe të dedikuar për këtë qëllim në kuadër të godinës komunale.**

✓ **Inkurajimi i mekanizmave të demokracisë pjesëmarrëse lokale**, siç janë iniciativat qytetare, peticionet, pyetjet për kryetarin e komunës dhe këshilltarët komunal, si dhe referendumi lokal.

✓ **Krijimi i një buxheti pjesëmarrës**. Aleanca për Shqiptarët angazhohet për ndarjen e detyrueshme të një buxheti pjesëmarrës në secilën komunë. Një pjesë e buxhetit të përgjithshëm komunal do të ndahet dhe do t'i nënshtrohet vendimmarrjes kolektive komunë – qytetarë, kryesisht në rrafshin e investimeve infrastrukturore nëpër lagje dhe fshatra. Të gjithë qytetarët mbi 16 vjeç do të kenë të drejtë pjesëmarrjeje. Në përgjithësi, buxheti pjesëmarrës është i organizuar në pesë faza dhe modalitete pjesëmarrëse: 1) Përkufizimi i modaliteteve (përmes shumës së buxhetit dhe rregullativës); 2) Grumbullimi i ideve për projekte nëpër lagje dhe fshatra; 3) Analiza e projekteve nga shërbimet teknike të administratës komunale për të verifikuar realizueshmërinë, ligjshmërinë dhe koston; 4) Votimi i projekteve prioritare për secilën lagje dhe fshat; 5) Zbatimi i projekteve.

✓ **Sistematizimi i bordeve/këshillave këshillëdhënëse** në fusha si planifikimi hapësinor, zhvillimi rural, arsimi, aftësimi profesional, fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, etj. Këto borde do t'u mundësojnë zyrtarëve të zgjedhur që të marrin njohuri të hollësishme për nevojat e qytetarëve, por dhe qytetarëve pjesëmarrës që të marrin pjesë në jetën politike komunale dhe të shprehin kërkesat e tyre.

## **Organet komunale, administrata komunale efikase, bashkëkohore dhe në shërbim të qytetarëve**

### **Shërbime komunale cilësore për të gjithë**

Komuna jonë do të jetë e hapur për të gjithë pavarësisht përkatësisë etnike, religjioze apo partiake. Do të krijojmë administratë komunale profesionale, e cila ka përgatitjen dhe kapacitetin që të ballafaqohet me sfidat bashkëkohore të vetëqeverisjes lokale.

Administrata komunale do të sistematizohet për t'iu përshtatur nevojave të qytetarëve, duke u bazuar në parimet e meritës, kualifikimit si dhe profesionalizmit.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektshmërisë së shërbimeve komunale, ne angazhohemi për promovimin dhe zbatimin e modelit të qeverisjes ndër-komunale, krahas forcimit të rajoneve planore dhe rritjes së bashkëpunimit mes tyre dhe komunave.

## **Organet komunale**

Edhe pse shumica e qytetarëve të komunës së Gostivarit, sigurisht që kanë njohuri për organet e komunës, megjithatë qëllimi i sqarimit të përbërjes së organeve të komunës, qëndron në dhënien e njohurive adekuate qytetarëve, në lidhje me kompetencat e këtyre organeve apo të drejtat dhe obligimet e tyre.

Qytetarëve të ju mundësohet identifikimi i fushëveprimit të këtij institucioni dhe me identifikimin e fushëveprimit të kenë njohuri edhe për pritshmëritë e tyre. Pra, prej komunës mund të kryhen aq punë sa janë në kompetencë të saj.

Organet e komunës janë: Kryetari i komunës dhe Këshilli i komunës.

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2002), dhe statutit të Komunës së Gostivarit, përcaktohen kompetencat respektivisht të drejtat dhe detyrimet e Kryetarit të komunës dhe Këshillit komunal.

Me qëllim të funksionimit efikas të komunës, në mënyrë të patjetërsueshme është i nevojshëm bashkëpunimi në mes të Kryetarit të komunës dhe Këshillit komunal.

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Kryetari komunës, përfaqëson komunën në të gjitha marrëdhëniet të cilat i themelon komuna, e që janë në kompetencë të tij dhe prezanton komunën si në nivel nacional, po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Përkujdeset për ligjshmërinë e dispozitave të Këshillit, kryen kontrollin e tyre, shpall dispozitat e Këshillit në buletin zyrtar të komunës, siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit, kryen të gjitha punët të cilat me ligj i janë deleguar komunës, respektivisht Kryetari i komunës përkujdeset për të gjitha punët me interes publik në nivel lokal.

Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 50), ia garanton këto kompetenca Kryetarit të komunës :

1. E përfaqëson dhe prezanton komunën
2. E kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të Këshillit;
3. I shpall dispozitat e Këshillit në buletin zyrtar të komunës;
4. E siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit;
5. E siguron kryerjen e punëve të cilat me ligj i janë deleguar komunës;
6. Inicion dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetencat e Këshillit;
7. E propozon buxhetin vjetor të komunës dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës.
8. E realizon buxhetin e komunës;
9. Zgjedh drejtorë të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna, në bazë të konkursit publik.
10. Rregullisht e njofton Këshillin për kryerjen e kompetencave të veta në përputhje me

statutin;

11. Vendos në punë administrative për të drejtat, obligimet dhe interesat e personave juridik dhe fizik, në përputhje me ligjin.

12. Sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale;

13. Udhëheq me administratën komunale;

14. Vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën e komunës, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe me ligj.

15. Siguron shfrytëzim të drejtë dhe ligjor, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pronës së komunës, në përputhje me ligjin dhe statutin; dhe

16. Kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin.

Kryetari i komunës krahas kompetencave të lartpërmendura kryen edhe punë të tjera të cilat përcaktohen me ligje të veçanta sipas të drejtës pozitive të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe sipas Statutit të komunës së Gostivarit.

### **Këshilli i Komunës**

Këshilli i komunës është organ kolektiv në kuadër të komunës.

Këshilli i komunës së Gostivarit përbëhet prej 31 (tridhjetë e një) anëtarëve, të cilët zgjidhen në zgjedhje të lira. Kryesisht janë anëtarë të caktuar të partive politike pasi që në të shumtën e rasteve, listat për këshilltarë propozohen nga partitë politike në RMV, por ka raste edhe të propozimit të listës për këshilltarë edhe nga iniciativa qytetare, lista të pavarura politikisht.

Roli i këshillit komunal është shumë i rëndësishëm, e sidomos në bashkërendimin e veprimeve së bashku me organin tjetër të komunës, Kryetarin e komunës.

Qeverisja lokale për të qenë e suksesshme, detyrimisht duhet të ketë përbërje funksionale të Këshillit komunal, të përbërë nga njerëz të cilët ia duan të mirën qytetit.

Me Këshillin komunal udhëheq Kryetari i këshillit i cili zgjidhet nga radhët e këshilltarëve me shumicë votash, nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Shumica e punëve në dobi të qytetarëve janë të varura nga Këshilli komunal.

Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 36), përcakton këto kompetenca të Këshillit komunal, edhe atë:

1. Sjell statutin e komunës dhe dispozita të tjera;
2. Sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të komunës;
3. Përcakton shumën e burimeve personale të të ardhurave të financimit të komunës, në suaza të përcaktuara me ligj;
4. Themelon veprimtari publike në suaza të kompetencave të komunës dhe bën mbikëqyrjen e punës së tyre;
5. Emëron anëtarë të Këshillave drejtues të veprimtarive publike të cilat i themelon;
6. Sjell programe për punë dhe plane financiare për financim të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
7. I miraton raportet për realizimin e buxhetit dhe llogarinë vjetore të komunës;
8. Vendos për dhënien e lejeve për kryerje të veprimtarisë të interesit publik me rëndësi lokale në përputhje me ligjin;

9. I miraton raportet për punën e veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
10. Vendos për mënyrën e disponimit me pronën e komunës.
11. Vendos mbi mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës në përputhje me ligjin.
12. Zgjedh personin që udhëheq me Njësinë rajonale të Ministrisë për punë të brendshme në komunë, në përputhje me ligjin;
13. Shqyrton dhe miraton Raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e komunës, të cilin e dorëzon deri te ministri i punëve të brendshme dhe Avokati i Popullit;
14. Mund t'i jep rekomandime personit udhëheqës të Njësisë rajonale të Ministrisë për punë të brendshme nga fusha e sigurisë publike dhe sigurisë në komunikacion dhe
15. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Këshilli komunal krahas kompetencave të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, mund të kryejë punë të cilat parashihen edhe me ligje tjera pozitive të RMV.

### **Administrata komunale**

Kryetari i komunës udhëheq me administratën komunale, po ashtu vendos për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e administratës komunale.

Bazuar në qeverisjen lokale nga viti 2017 deri në vitin 2021, është mundur identifikimi i të metave të administratës komunale, të cilat vazhdimisht janë përmirësuar me qëllim të shërbimit sa më efikas ndaj qytetarëve.

### ***Çfarë planifikojmë të bëjmë me administratën komunale, në periudhën 2021-2025!***

Në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2025, do të bëjmë përpjekje që të krijojmë një administratë komunale e cila do të jetë „role model” në nivel kombëtar.

Fillimisht do të bëhet sistematizimi i ri i administratës komunale, duke vendosur persona të përgjegjshëm, kompetent në pozicione përkatëse, e gjithë kjo në bazë të analizës funksionale të realizuar paraprakisht, nga ekspertë të fushës.

Secili nëpunës administrativ gëzon të drejta të garantuara, asnjë nuk do të nënvlerësohet apo mbivlerësohet. Do të bëhet vlerësimi i punës së çdonjërit nëpunës administrativ dhe brenda një muaji apo eventualisht në çdo tre muaj, do të shpallet nëpunësi administrativ më i suksesshëm, me çka do të rritet motivi dhe dëshira për punë.

Maksimalisht do të kujdesemi të respektohet parimi i vendosjes në kohë të arsyeshme, me çka shërbimi ndaj qytetarëve, është dhe do të jetë privilegj për administratën komunale. Do të krijojmë mekanizëm adekuat të ndjekjes së lëndës, me çka qytetarët, respektivisht pala në procedurë në çdo kohë do të ketë mundësi të ndjek në cilën stad ka arritur lënda e tij.

### **Aleanca për Shqiptarët propozon:**

✓ **Rritje të motivimit të personelit komunal duke rritur dinamizmin e politikës së burimeve njerëzore përmes mekanizmave siç janë portfoliot për zhvillim të karrierës (objektivat, treguesit, vlerësimi, trajnimi, zhvillimi i karrierës, mirëqenia në punë, cilësia e mjedisit të punës, etj.).**

✓ **Promovoni i dygjuhësisë së personelit komunal përmes organizimit të kurseve falas për nëpunësit civil në gjuhën zyrtare të komunës që dallon nga gjuha e tyre amtare.**

✓ **Trajnimi dhe licencimi i personelit komunal në teknologjitë informative, me kosto të mbuluara nga komuna dhe me qëllim të rritjes së kapaciteteve komunale për transformim digjital.**

✓ **Instalimi i sporteve elektronike që ofrojnë shërbime të vazhdueshme, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, për tërheqje të dokumenteve komunale dhe certifikatave, si dhe për të dorëzuar kërkesa administrative drejtuar shërbimeve komunale.**

✓ **Organizimi më i mirë dhe i hapur i pritjes së qytetarëve në godinën komunale:** orë më të gjera të hapjes që korrespondojnë me nevojat e qytetarëve, sistem të tiketave, sinjalizimi vizual i godinës në bazë të shërbimeve komunale, mini biblioteka dhe kënd të lodrave në sallën e pritjes, etj. Qytetarët do t'i marrin të gjitha shërbimet e nevojshme nga autoritetet lokale në një vend të hapur.

✓ **Qasje më e mirë në infrastrukturën komunale për personat më lëvizshmëri të zvogëluar.** Kjo vlen si për administratën komunale ashtu edhe për objektet sportive, lokalet në dispozicion të shoqatave, qendrat kulturore, etj., përfshirë sinjalizimin me alfabet Braille.

✓ **Hapja e zyrës së veçantë për paraqitjen e pakënaqësive, pengesave, korrupsionit apo burokratizimit nga administrata komunale.**

Në kuadër të administratës komunale do të caktohet zyrë e veçantë për paraqitje të pakënaqësive, pengesave në procedurë, korrupsionit apo edhe burokratizimit nga administrata komunale. Asnjë institucion nuk është imun ndaj këtyre dukurive negative, andaj paraqitja dhe bashkëpunimi me organet kompetente do të jetë mënyrë më efiçase për luftimin e të gjithë dukurive negative të cilët i prekin interesat shoqërore në përgjithësi.

✓ **Zyra e veçantë për diasporën e cila ofron informacione dhe shërbime falas për mërgimtarët është mjaftë funksionale në Komunën e Gostivarit, në mandatin e ardhshëm do të mundohemi për digjitalizim të kësaj zyre për ofrimin e shërbimeve administrative, qofshin të nivelit lokal apo qendror.**

✓ **Forcimi i kapaciteteve të zyrës për subvencione dhe grande në çdo komunë, me një zyrtar të specializuar në kërkimin e subvencioneve dhe thirrjeve për projekte, qofshin ato shtetërore, rajonale, evropiane, nga ambasadat dhe agjencitë zhvillimore apo nga sektori privat.**

✓ **Promovimi i një shërbimi cilësor dhe me kosto më të ulët për qytetarët në sektorët e shpërndarjes së ujit, planifikimit hapësinor apo trajtimit të mbeturinave.** Krahas rritjes së pagesës dhe digjitalizimit të orëve matëse për ujë të pijshëm, ne do të promovojmë krijimin e ndërmarrjeve ndër-komunale në mënyrë që të ulen kostot e shërbimeve publike përmes ekonomisë së shkallës.

## **Transformimi digjital**

Zhvillimi i teknologjive digjitale ndikon në zhvillimin e shoqërisë në të gjitha fushat. Teknologjitë digjitale optimizojnë dhe lehtësojnë biznes proceset, proceset edukativo arsimore si dhe aspektet e ndryshme jetësore. Ato sigurojnë qasje të shpejtë dhe të lehtë në informacion,

lehtësojnë dhe mundësojnë një mori shërbimesh për qytetarët, në të gjitha aspektet e jetës lokale (arsimi, administrata publike, mobiliteti, informimi i qytetarëve, turizmi, kultura, etj.). Përveç kësaj, tanimë është botërisht e njohur se teknologjitë digjitale inkurajojnë zhvillimin ekonomik, nxisin inovacionin dhe transparencën.

Megjithatë, transformimi digjital zakonisht anashkalohet nga institucionet publike dhe të njëjtat nuk e kanë në fokus digjitalizimin në nivel të institucionit.

Natyrisht, zbatimi i politikave efektive për "qytete inteligjente" (smart cities) nuk varet vetëm nga komunat dhe mund të bëhet në mënyrë efektive vetëm në një kontekst ku luftohet ndarja digjitale që prek një pjesë të qytetarëve, duke u siguruar mbulim 4G si dhe WIFI cilësor dhe me çmim të arsyeshëm në të gjithë territorin.

Ne do të punojmë që çdo qytetar të ketë qasje në internet, si një e drejtë themelore njerëzore. Duke siguruar internet në të gjithë territorin e komunës, do të zvogëlojmë pabarazinë digjitale në popullatë dhe do të mundësojmë ndërveprim me qytetarët e komunës në kohë reale. Duke dhënë mundësi për qasje në internet për çdo qytetar, do të vazhdojmë t'i inkurajojmë ata për përvetësimin e njohurive teknologjike përmes edukimit joformal, që komuna do ta ofrojë në mënyrë sistematike duke krijuar mundësi aftësimi për çdo qytetar dhe biznes lokal.

#### **Sa u përket shërbimeve komunale:**

Qeverisja elektronike (ose e-qeverisja), përveç se ndihmon në efikasitet, ajo ulë edhe kostot komunale. Përvojat e ndryshme ndërkombëtare dëshmojnë se në vendet ku qeveritë kanë zbatuar programe të e-qeverisjes, është ulur dukshëm niveli i korrupsionit përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke kontribuar kështu edhe në forcimin e qeverisjes së mirë. Aleanca për Shqiptarët beson se kjo qasje do të ndihmojë në afrimin e shërbimeve deri te qytetarët dhe do të jetë një mjet efektiv në luftën kundër korrupsionit, duke siguruar më shumë transparencë, informacion të hapur dhe rritje të llogaridhënies.

#### **Më konkretisht, do të angazhohemi për zbatimin e masave në vijim:**

✓ **Digjitalizimi i infrastrukturës administrative komunale** do të kontribuojë në modernizimin dhe efikasitetin e të gjithë sektorëve në komunë si dhe ngritjen e cilësisë së jetesës për çdo qytetar. Transformimi digjital do të mundësojë që të përmirësohet zhvillimi, si dhe decentralizimi dhe transparenca e menaxhimit komunal. Shërbimet do të jenë më të shpejta, me efçiente dhe më të qasshme. Do të stimulojmë dhe përkrahim ide të reja për përmirësimin e infrastrukturës digjitale si në nivel komunal ashtu edhe në nivel rajonal. Duke përmirësuar infrastrukturën digjitale dukshëm do të zvogëlojmë edhe evazionin fiskal.

✓ **Instalimi i sporteleve elektronike** që ofrojnë shërbime të vazhdueshme, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, të destinuara për të tërhequr dokument komunale dhe certifikata, si dhe për të dorëzuar kërkesa administrative të shërbimet komunale.

✓ **Një platformë unike online për komunat.** Kjo platformë do të përfshijë edhe ndërmarrjet publike përkatëse, sidomos ujësjellësin dhe kanalizimet, me çka do të garantohet shfrytëzimi i të gjitha shërbimeve elektronike (informacione, kërkesa, parashtrësia, ankesa, denoncime, leje, pagesa elektronike të taksave dhe tatime lokale). Platforma online do të shoqërohet me një aplikacion komunal për informim të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe ndërveprim në kohë reale me autoritetet komunale.

✓ **Zbatimi i një politike të të dhënave të hapura (open data)** dhe qasje e lirë në të dhënat me karakter të interesit publik, për transparençë totale të përdorimit të mjeteve komunale, rekrutimeve në administratë dhe një menaxhim më të mirë të komunës. Duke krijuar mundësi për qasje në të dhëna që janë me interes publik, do të garantojmë lirinë e shprehjes dhe të mediave lokale me çka për çdo komunë do të krijohen portale ndërvepruese për komunikim në kohë reale me mediat lokale, bizneset, organizatat joqeveritare, ato edukative si dhe me çdo qytetar të komunës. Kjo qasje do të zvogëlojë kufizimin që mediat dhe shtypi kanë pasur deri më tani, do të rrisë dhe garantojë lirinë e shprehjes, si dhe do të zvogëlojë diskriminimin dhe ndarjet sociale dhe etnike.

✓ **Fond special për investime në teknologji, për mirëmbajtjen e infrastrukturës digjitale dhe modernizimin e saj.**

**Për sa i përket cilësisë së jetesës:**

✓ **Krijimi i një shërbimi komunal për ndërhyrje të shpejtë për eliminimin e deponive të egra.** Në këtë drejtim, do të investohet në krijimin e mundësive për qytetarët për të lajmëruar shërbimet kompetente përmes rrjeteve sociale ose përmes aplikacionit komunal.

✓ **Forcimi i rrjetit të ndriçimit rrugor dhe përshtatja e tij me specifikat e hapësirës publike,** në veçanti përmes ndriçimit inteligjent (ndriçim bazuar në detektimin e lëvizjeve).

✓ **Vendosja e kontejnerëve inteligjentë, të cilët sinjalizojnë në mënyrë elektronike kur janë të mbushur dhe furnizohen me energji nga panelet diellor.**

**Për sa i përket mobilitetit:**



✓ **Mbështetja e modaliteteve të reja të transportit publik, në mënyrë që të ofrohet shumëllojshmëri ofertash përmes përdorimit të përbashkët të automjeteve (car pooling dhe car sharing) përmes teknologjive dhe platformave bashkëpunuese digjitale.**

✓ **Zhvillimi i infrastrukturës inteligjente për menaxhimin e trafikut, për të rritur rrjedhshmërinë e trafikut, sigurinë rrugore dhe ndikimin pozitiv në mjedis.**

**Për sa i përket ekonomisë dhe turizmit:**

✓ **Krijimi i qendrave për inovacion** (“innovation hubs”), inkubatorëve dhe përsheptuesve, qendrave për arsim joformal dhe bibliotekave digjitale publike në çdo komunë. Këto qendra do të themelohen përmes partneriteteve publiko-private dhe do të shërbejnë si trampolina për ide të reja dhe inovacione, duke ndihmuar kështu shoqërinë dhe ekonominë lokale që të përballen me sfidat e së ardhshmes dhe aspiratat e të rinjve. Përmes këtyre qendrave, çdo qytetar i komunës, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e tij, do të ketë një hapësirë për trajnim dhe zbatim të projekteve digjitale.

✓ **Krijimi i një ueb faqe dhe e një aplikacioni komunal** apo ndër-komunal që listojnë dhe promovojnë monumentet dhe hapësirat me interes turistik brenda territorit të komunës, si dhe ofertën hoteliere, përfshirë bujtinat rurale.

✓ **Zhvillimi i një rrjeti shtigjesh dhe shëtitorësh të gjelbra dhe rurale, në bashkëpunim me Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.**

**Siguri në çdo cep të komunës**

Në Komunën e Gostivarit ne do të zbatojmë politikën e zero tolerancës ndaj veprimeve delikuede dhe degraduese të hapësirës publike. Për shkak të afërsisë me qytetarët dhe njohurisë se terrenit, komuna është mjaftë e aftë të veprojë në mënyrë efektive për të rritur sigurinë në lagjet dhe fshatrat tona. Ne do të zhvillojmë reagime shumëdimensionale përmes edukimit, informimit, parandalimit, politikave të afërsisë me qytetarët dhe planifikimit të duhur të hapësirës publike.

**Aleanca për Shqiptarët propozon:**

✓ Në bashkëpunim me autoritetet qendrore, **organizimin e kornizës ligjore për krijimin e një shërbimi komunal parandalues** (“paqeruajtës”) përgjegjës për parandalimin e veprimeve delikuede dhe degraduese të ambientit apo infrastrukturës komunale, përfshirë sigurinë përreth shkollave dhe objekteve komunale. Ky shërbim do të veprojë si lidhje midis komunës dhe qytetarëve, duke njoftuar shërbimet komunale kompetente për problemet me të cilat përballen qytetarët.

✓ **Dënime administrative për të gjitha veprimet delikuede dhe degraduese të hapësirës publike: degradimi i orendive të rrugëve, ndotja e rrugëve komunale, deponitë ilegale.**

✓ **Instalimi i një sistemi të kamerave inteligjente**, për të mundësuar ndërhyrje të shpejta dhe të decentralizuara aty ku është e nevojshme, në veçanti për të luftuar kundër deponive ilegale dhe vjedhjeve në shtëpitë dhe shitoret e qytetarëve.

✓ **Zbatimi i një plani të ndriçimit të qëndrueshëm**, edhe pse në mandatin katër vjeçar në komunën e Gostivarit ndërtuam mbi njëzet linja të reja të ndriçimit publik, ne do të vazhdojmë të mundësojmë vënien në pah të trashëgimisë komunale dhe do të kontribuojmë në rritjen e ndjenjës së sigurisë me ndërtimin e linjave të reja të ndriçimit, dhe do të hartojmë plane për uljen e konsumit të përgjithshëm të energjisë.

✓ **Forcimi i shërbimeve zjarrfikëse**. Gjatë mandatit në të cilin qeverisëm me komunën e Gostivarit, për heronjtë tanë siguroam kushte më të mira për punë, uniforma të reja, ngrohje qendrore dhe ambient të rinovuar pushimi, por e shohim si të domosdoshme që zjarrfikësit të pajisjen me materialin e duhur bashkëkohor dhe të optimizohet numri i përgjithshëm i zjarrfikësve, për të garantuar shërbim efikas dhe ndërhyrje në kohë optimale, përfshirë përmes bashkëpunimit ndër-komunal.

✓ **Zgjidhja e problemit të qenve dhe maceve endacake**, ndërtimi i dy strehimoreve për qentë endacak zbuti sa do pak problemin e vazhdueshëm me të cilin ne si komunë jemi ballafaquar, andaj premtojmë se do të vazhdojmë në zgjidhjen e problemit edhe për katër vitet e ardhshme duke u dhënë subvencion qytetarëve që duan të sterilizojnë dhe shënjojnë qentë dhe macet e tyre, dhe duke krijuar strehimore rajonale për qentë endacak. Ne, gjithashtu do të krijojmë një shërbim veterinar komunal, përgjegjës për shënjimin e qenve endacak, sterilizimin e tyre dhe krijim e një baze të dhënash, në bashkëpunim me shoqatat për mbrojtjen e kafshëve. Kjo do të kontribuojë në më tepër mirëqenie për kafshët dhe më tepër siguri për qytetarët.

## **Komuna e mirëqenies për të gjithë**

Mungesa e mirëqenies dhe e kohezionit social, dhe pabarazia, në planin afatshkurtër veprojnë si pengesa në integrimin e vendit në BE, sepse qeveritë e BE-së po bëhen gjithnjë e më rezistuese karshi integritit të shteteve që qëndrojnë larg BE-së me këto tregues.

Rreziku, në plan afatgjatë, është që fuqia jonë punëtore më e kualifikuar, përfshirë profesionet e mjekësisë, akademikët, studentët dhe teknikët e kualifikuar, do të humbin shpresën dhe durimin dhe ata do të zgjedhin të integrohen vetë në BE, duke ikur në mënyrë masive drejt vendeve që ofrojnë mundësi më të mira për ta dhe familjet e tyre. Kjo do të ishte shkatërrimtare për të ardhmen e vendit. Nuk është për t'u neglizhuar as dukuria e migrimit të brendshëm të klasave të mesme të cilat ikin drejt qendrave më të zhvilluara që ofrojnë mundësi dhe perspektivë më të mirë.

Ne angazhohemi për komunë zhvillimore, të bazuar në mbrojtjen e mjedisit jetësor, në të cilin qytetarëve u ofrohet infrastrukturë dhe shërbime publike cilësore, të digjitalizuar dhe inovative. Vizioni jonë për vetëqeverisjen lokale është rritja e investimeve, brenda mundësive buxhetore të komunave, në kapitalin tonë mjedisor dhe atë njerëzor, duke u përqendruar në këto prioritete: mjedisi, arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, kultura dhe sporti.

## **Mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit jetësor**

Maqedonia e Veriut përballet me një emergjencë të vërtetë mjedisore. Vendi ynë ka cilësinë më të dobët të ajrit në kontinent dhe regjistron nivele të vdekshmërisë nga ndotja e ajrit dy deri në tri herë më të larta se mesatarja evropiane. Qytetet tona rregullisht radhiten si më të ndotur në

botë sa i përket cilësisë së ajrit.

Edhe përkundër kësaj emergjence, mjedisi dhe ruajtja e tij nuk ka qenë prioritet i asnjërës nga qeveritë e deritanishme në Maqedoninë e Veriut. Buxheti i dedikuar për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendi është jashtëzakonisht i ulët, ndërkohë që nuk stimulohet vetëdijesimi mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit në nivelin lokal dhe domosdoshmëria e mbikëqyrjes dhe ndëshkimit të ndotësve.

Pra, me të drejtë, mjedisi jetësor, pastërtia publike dhe cilësia e ajrit janë ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve në nivelin lokal. Përmirësimi i mjedisit jetësor në nivelin lokal arrihet veçanërisht përmes pastërtisë publike, si një nga barometrat kryesor të cilësisë së jetës që inkurajon njëkohësisht respekt më të madh për hapësirën publike, si dhe përmes menaxhimit dhe trajtimit efikas të mbeturinave, mbrojtjes së tokave bujqësore nga degradimi, mbrojtjes së lumenjve dhe pyjeve, e deri tek adresimi i ndotjes së ajrit të shkaktuar nga aktivitetet industriale dhe private.

Shumë nga këto çështje janë përgjegjësi e nivelit qendror dhe varen më së shumti nga investimet qeveritare. Megjithatë, komuna është aktor i rëndësishëm i mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe mund të ndikojë drejtpërdrejtë në këtë rrafsh.

### **Ne propozojmë një sërë masash për të arritur këtë synim.**

✓ **Përmirësimi i cilësisë së ajrit, duke ngritur koordinimin midis autoriteteve qendrore dhe atyre lokale** dhe duke siguruar burime adekuate financiare. Masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit do të zhvillohen për të gjitha zonat ku nivelet e ndotjes i tejkalojnë vlerat e lejuara. Gjatë qeverisjes tonë ne jemi kujdesur vazhdimisht për rinovimin e parkut të qytetit në të cilën investuam 1000 m<sup>2</sup> shtigje të reja për këmbësorë, 200 spërkatëse automatike për vaditje me qëllim të ruajtjes së cilësisë së gjelbërimit, 86 ulëse të reja e sidomos ulëset për personat me nevoja ndryshe, investuam në ndriçimin publik dhe këndet e lojërave, të cilët i mundësojnë parkut përpos tjerave të jetë edhe një vend rekreativ për qytetarët e Gostivarit tonë. Po ashtu ndërtoam 500m metra shtigje për biçikleta dhe subvencionuam më shumë se 300 biçikleta. Të gjitha këto investime janë realizuar me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit në qytetin tonë të dashur Gostivarin.

Edhe përpos kësaj ne do të krijojmë regjistër lokal për matjen e cilësisë së ajrit me pika fikse në komunën tonë. Masat shtesë për përmirësimin e cilësisë së ajrit do të përfshijnë favorizimin e makinave elektrike apo me gaz për nevojat e shërbimeve komunale, mbjelljen e druve me rritje të shpejtë dhe me kapacitete të larta të pastrimit të ajrit, dhe shpërndarjen e druve zbukurues dhe pemorë falas nga komuna për çdo qytetar të interesuar, një herë në vit në një ditë që do të caktohet nga komuna.

✓ **Mbështetja e ekonomisë qarkore në menaxhimin e mbeturinave.** Kudo që është e mundur, do të promovojmë operacionalizimin e ndërmarrjeve ndër-komunale të menaxhimit të mbeturinave. Gjatë mandatit të ardhshëm do të bëjmë dislokimin e deponisë Rusino nga qyteti.

✓ **Impiante të reja ko-incinerimi.** Maqedonia e Veriut që nga viti 2000 ka në veprim vetëm një incinerator me një kapacitet maksimal prej një ton në ditë. Kjo nuk është e mjaftueshme. Prandaj, në bashkëpunim me autoritetet qendrore, donatorët dhe sektorin privat,

do të investojmë në impiante të reja ko-incinerimi në nivel ndër-komunal me kapacitete të ndryshme dhe varësisht nga nevojat e komunave.

✓ **Lufta e pa kompromis kundër veprimeve degraduese të hapësirës publike përmes shërbimit komunal për parandalim dhe dënimeve administrative.** Gjithashtu do ti japim përparësi pastërtisë së hapësirës publike përmes operacioneve të ndërgjegjësimit që kanë për synim përfshirjen e qytetarëve.

✓ **Rritja e frekuencës së pastrimit të rrugëve dhe të numrit të pastruesve.** Komuna e Gostivarit ka siguruar aparatura të reja, ka rritur numrin e pastruesve me qëllim krijimin e kushteve më të mira të punës dhe punëtorëve që të jenë sa më ekspeditiv në mbajtjen e higjienës duke i motivuar punonjësit e higjienës me rritjen prej 75% të rrogave. Ndërkaq për mandatin e ardhshëm planifikojmë ndarjen e pastrimit në sektorë, të cilët do të përdoren për të vlerësuar pastërtinë në kohë reale.

✓ **Mbikëqyrje e përhershme e pastërtisë publike,** përmes një raporti vjetor që do të paraqitet në Këshillin komunal (personeli, numri i ndërhyrjeve, zonat kritike, grumbullimi i mbeturinave). Kjo mbikëqyrje duhet të bëjë matjen e gjendjes reale të pastërtisë publike si dhe vlerësimin e banorëve për të.

✓ **Vendosja e kontejnerëve inteligjentë,** më respektues për peizazhin urban, më bindës kundër deponive klandestine, duke siguruar mirëmbajtjen e pastërtisë rreth tyre, përfshirë përmes mbikëqyrjes së shtuar përmes kamerave dhe mundësisë së sinjalizimit të shkeljeve përmes aplikacionit komunal.

✓ **Grumbullimi nga ndërmarrjet komunale të gjësendeve të mëdha si mobile të vjetra dhe pajisje shtëpiake, të destinuara për riciklim dhe ridestinin përmes një platforme bashkëpunuese (B2B dhe B2C).**

✓ **Zbatimi i klasifikimit selektiv të mbeturinave në hapësirën publike si dhe gjatë ngjarjeve festive dhe sportive të organizuara në territorin e komunës, me detyrimin për organizatorët që të përdorin maksimalisht materiale të riciklueshme.**

✓ **Inkurajimi i nismave lokale që synojnë luftimin e shpërdorimit të ushqimit të pa shitur nga shitoret, tregjet, etj., duke i ndërlidhur këta aktorë ekonomik me shoqatat që u ndihmojnë njerëzve në vështirësi.**

✓ **Ruajtja, mirëmbajtja dhe rritja e hapësirave të gjelbra, zonave natyrore si dhe mbrojtja e biodiversitetit.**

✓ **Ngrirja e menjëhershme e zgjerimit urban anarkik si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale me qëllim të ruajtjes së zonave të gjelbra, të pyllëzuara dhe atyre bujqësore.**

✓ **Rritja e efikasitetit energjetik të ndërtesave publike.** Do të bëhet auditimi i plotë energjetik i ndërtesave në pronësi apo menaxhim të komunës, përfshirë një regjistër të sipërfaqeve së çative të ndërtesave komunale. Ndërtesat publike do të kenë prioritet të lartë në masat për efikasitet energjetik, veçanërisht përmes investimit në izolim dhe në projekte të energjisë së ripërtëritshme, me synim të uljes së konsumit të karburanteve të ngrohjes për 40% dhe e konsumit të energjisë elektrike për 15% deri në vitin 2025 për të gjitha ndërtesat në pronësi apo menaxhim të komunës. Do të aplikojmë në projekte evropiane për energji efikase

me synim të përmirësimit të performancës energjetike të ndërtesave komunale.

- ✓ **Instalimi i rezervuarëve për mbledhjen e ujit të shiut në ndërtesat në pronësi apo menaxhim të komunës për të mbuluar një pjesë të nevojave bazike të ndërtesave publike dhe kursyer ujin e pijshëm.**
- ✓ **Subvencione shtesë krahas atyre qeveritare, për të inkurajuar kursimin e energjisë dhe praktikat e mira mjedisore siç janë instalimi i paneleve fotovoltaike, rezervuarëve për mbledhjen e ujit të shiut, etj., përfshirë në ndërtesat e banimit kolektiv.**
- ✓ **Promovimi përmes urbanizmit të vegjetalizimit urban kudo që është e mundur, veçanërisht në çatitë e ndërtesave komunale, dhe atyre kolektive apo afariste.**
- ✓ **Krijimi i një zyre komunale të energjisë i cili centralizon të gjithë informatat e dobishme rreth përdorimit efikas të energjisë dhe subvencionet qeveritare dhe komunale, dhe i cili këshillon dhe përkrah qytetarët në aplikimet e tyre për subvencione.**
- ✓ **Krijimi, brenda mundësive buxhetore të komunës, të një sektori komunal për mbrojtjen e mjedisit, i cili përveç misioneve specifike të mbrojtjes së mjedisit dhe pastërtisë publike, do të këshillojë të gjithë shërbimet komunale rreth ndikimit të tyre mjedisor. Sa u përket kapaciteteve njerëzore për këtë shërbim, do të stimulojmë aktivizimin e pensionistëve në nivel lokal.**

## **Shëndetësia**

Sfidat shëndetësore, me të cilat sot ballafaqohet vendi janë të ndërlydhura me një sërë faktorësh social, ekonomik dhe mjedisor, të cilët kërkojnë një analizë më të detajuar për përgatitjen e programeve dhe strategjive shtetërore gjithëpërfshirëse të sistemit tonë shëndetësor dhe sektorëve që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në këtë sistem, me qëllim të rritjes së efikasitetit në përballje me këto sfida dhe me synim për përmirësimin e shërbimit shëndetësor dhe mjekësor sa më cilësor, dhe ngritje të cilësisë së jetesës.

Në këtë kuptim, pasojat e shkaktuara nga pandemia Kovid-19 dëshmuar se shteti dhe institucionet shëndetësore dështuan në menaxhimin e kësaj situatë. Ky dështim erdhi si pasojë e neglizhencës dhe gabimeve në koncept për të sotmen e shëndetësisë sonë dhe mungesës së vizionit për zhvillimin e saj në përputhshmëri me nevojat dhe objektivat që i kërkon e nesërmja e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve.

Komuna do të mundësojë qasje në shërbime shëndetësore cilësore për të gjithë duke e promovuar shëndetin në të gjitha politikat. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e shëndetësisë primare, do të ndihmojmë në shtrirjen e sistemit shëndetësor primar në tërë territorin e komunës dhe gjatë 24 orëve.

Ne do të tregojmë kujdes të veçantë për edukimin shëndetësor të popullatës, promovimin e sportit dhe parandalimin e përdorimit abuziv të produkteve të dëmshme për shëndetin, siç janë lëndët narkotike, duhani, alkooli, etj. Ne do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë shëndetit mjedisor, shëndetit në punë dhe do të sigurojmë që të respektohen në përpikëri rregulloret dhe ligjet për mos dëmtimin e shëndetit.

## **Për sa i përket fushës së përgjegjësisë së komunave, propozojmë:**

- ✓ **Bashkimin e shtëpive të shëndetit me spitalet e përgjithshme të qytetit, me përjashtim të Qytetit të Shkupit. Kjo do të sigurojë funksionalitet më të mirë dhe ulje të shpenzimeve shëndetësore.**
- ✓ **Do të angazhohemi për rritje të investimeve në renovimin e infrastrukturës së vjetruar si dhe në ndërtimin e kapaciteteve të reja në të gjitha qytetet kryesore.**
- ✓ **Do të angazhohemi për hapje të qendrave për mjekësi urgjente**

## **Arsimi**

Dëshmitë shkencore flasin se frekuentimi më i lartë në arsimin parashkollor, autonomia më e madhe e institucioneve të arsimit si dhe ulja e boshllëkut në arsimin profesional, e rrisin dukshëm kapitalin njerëzor, ndërkohë që përmirësohet efikasiteti i sistemeve arsimore. Për më tepër, ulja e pabarazive në arsim dhe ofrimi i mundësive të barabarta janë thelbësore për të promovuar rezultate më të mira arsimore.

Në Maqedoninë e Veriut, edukimi parashkollor është veçanërisht problematik, me vetëm rreth 30% të fëmijëve të regjistruar në institucionet e licencuara parashkollore. BE-ja në objektivat e saj për arsim dhe aftësim synon pjesëmarrjen e 95% të fëmijëve në edukimin parashkollor.

Sidomos situata në rajonin e Pollogut është e papranueshme dhe shifrat tregojnë se ky rajon ka bindshëm rezultatet më të këqija krahasuar me rajonet tjera, me vetëm 9,1% të fëmijëve deri në moshën 5 vjeçe që shkojnë në kopsht. Rajonet tjera qëndrojnë shumë më mirë. Për shembull rajoni Lindor ka 42,5% të fëmijëve të së njëjtës moshë që shkojnë në çerdhe.

Edhe pse shpenzimet publike për arsim në Maqedoninë e Veriut janë rreth 4% të prodhimit bruto vendor, pra thuhet në nivelin e mesatares së vendeve të BE-së, rezultatet arsimore të nxënësve tanë janë shumë më të dobëta se ato të bashkëmoshatarëve të tyre nga rajoni. Pra, problemi i cilësisë në arsim në të gjitha nivelet vjen jo aq nga mungesa e investimeve në terma absolute, por nga mënyra e gabuar e investimit, e cila është thellësisht e ndikuar nga politika dhe në esencë është korruptive.

Gjendja e cilësisë në arsim dëshmohet më së miri nga rezultatet e Programit të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA), ku Maqedonia e Veriut renditet si një nga performueset më të dobëta në botë. Sipas Bankës Botërore, bazuar në llogaritjet e të dhënave PISA, me ritmin e tanishëm të përparimit, Maqedonisë së Veriut do t'i duhen tre dekada për ta arritur mesataren e aftësisë për të lexuar të vendeve të BE-së.

Menaxhimi i mirë i sistemit arsimor është parakusht që fëmijët tanë të jenë konkurrues në tregun e punës dhe të gjejnë punë që përputhet me kompetencat e tyre. Prioriteti ynë kryesor në komunën e Gostivarit ishte dhe do të jetë modernizimi dhe përmirësimi i procesit arsimor. Kujdesi për mësimdhënie cilësore dhe kushtet cilësore të punës në shkolla do të jetë preokupim ynë i përditshëm.

Në mandatin e kaluar katër vjeçar komuna e Gostivarit ashtu siç premtoj në fushatën zgjedhore

2017-2021, e mbajti premtimin si nga aspekti i modernizimit të shkollave fillore dhe të mesme, përmirësimi i procesit arsimor, investimi kapital dhe infrastrukturor nëpër shkolla, kujdesi për mësimdhënës cilësor, ku në këto raste prioritet ka qenë interesi publik e jo ai partiak dhe për tre vite e gjysmë kemi ndarë 143 vendime të përhershme pune për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme duke u bazuar në ndjekjen e parimit për të pasur kuadër adekuat cilësor dhe duke mënjanuar çdo bindje e ndikim partiak.

Në mandatin e ardhshëm prioritet i ynë përsëri do të jenë objektet arsimore deri sa çdo shkollë të ketë pamjen e shkollave bashkëkohore evropiane.

#### **Sa u përket çerdheve:**

✓ **Komuna e Gostivarit** për periudhën prej vitit 2017-2021 prioritet ka pasur investimet kapitale në çerdhet e qytetit ku për tre vite janë investuar 16.070.432 denarë dhe janë ndërtuar edhe pesë çerdhe të reja si dhe qëndrime ditore dhe atë çerdhja në fshatin Banjicë “Dielli”, çerdhja në fshatin Çegran “Përparimi”, si dhe qendrat ditore në Forinë, Debresh, Raven, dhe lagja Cigllana. U realizuan edhe 20 punësime të reja si dhe u ulë dukshëm numri i fëmijëve të regjistruar në listë pritjeje nga 200 në 80 fëmijë.

Edhe përpos këtyre të arriturave nga mandati i kaluar ne e shohim shumë të arsyeshme hapjen e mëtejshme të çerdheve të reja dhe qëndrimeve ditore edhe për zonat rurale ku nevojat janë të domosdoshme si dhe do ti zbatojmë masat në vijim:

✓ **Inkurajimi i krijimit të strukturave plotësuese, siç janë çerdhet me bazë në komunitetit**, çerdhet private dhe forma tjera siç janë kujdesi ditor, i organizuar nga individë dhe shoqata të licencuara, në pajtueshmëri me praktikën evropiane.

✓ **Subvencione publike për familjet të cilave nuk mund t’u sigurohet vend në çerdhet publike.** Nëpërmjet programit për ndihmë ndaj fëmijëve në moshë parashkollore, në bashkërendim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale, familjet të cilave nuk mund t’u sigurohet një vend në çerdhet publike, do të kenë të drejtë për subvencionim prej 30% të kostos së çerdhes private në territorin e komunës ku jeton fëmija, familja ose të paktën njëri nga prindërit.

#### **Sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm:**

Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe planifikimi i hapësirave të reja shkollore, janë nga projektet që komuna e Gostivarit ka finalizuar me sukses duke investuar kështu 18.809.220 denarë në arsimin fillor dhe 8.440.596 denarë në arsimin e mesëm vetëm për tre vitet e fundit pa mos llogaritur vitin 2021, periudhë në të cilën shumë nga shkollat tona kanë marrë pamjen e shkollave bashkëkohore evropiane siç është çatia e Sh.F.K “Goce Dellçev”, e cila edhe pse ishte nën kompetencë të Ministrisë së arsimit dhe shkencës dhe qeverisë e cila për pesë vite rrezikonte jetën e nxënësve dhe punonjësve, komuna e Gostivarit me ndihmën e UNDP ndërtoi një çati bashkëkohore dhe me standarde evropiane. Janë realizuar investime sanitare gati në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, lyerje me laç, ndërtim i 24 kabineteve në shkollat fillore dhe të mesme nga ku 18 në shkollat e mesme duke i dhënë prioritet shkollave profesionale siç janë shkolla e mesme e mjekësisë dhe shkolla e mesme teknike komunale ku janë arritur rezultate mjaft të larta inovative si bashkëpunim me ndërmarrjet dhe institucionet relevante ku ka pasur gërshetim të teorisë dhe praktikës që ka përmirësuar dukshëm të arriturat tek nxënësit.

Mjaftë me rëndësi është edhe mbështetja që ua kemi dhënë shkollave për organizimin e shkollave verore në bashkëpunim me organizatat e ndryshe joqeveritare që kanë qenë risi në qytetin tonë dhe mjaftë tërheqëse për nxënësit. Vlen të përmenden edhe Bursat për fëmijët e talentuar apo që vijnë nga familjet me nevojë. Si komunë kemi promovuar pjesëmarrjen e nxënësve të talentuar në gara ndërkombëtare, regjionale dhe komunale duke i shpërblyer me mjete financiare për katër vite radhazi.

**Pavarësisht finalizimit të këtyre projekteve ne do të vazhdojmë edhe me:**

- ✓ **Promovimi i mësimi të njohurive themelore me vëmendje të veçantë në gjuhën amtare, veçanërisht rrjedhshmërinë në të folurit, lexim dhe shkrim. Kjo do të arrihet përmes aktiviteteve jashtë plan programit shkollor.**
- ✓ **Binjakëzimi i shkollave të komunave tona me së paku një shkollë në Kosovë dhe Shqipëri.**
- ✓ **Përmirësimi i cilësisë së arsimit përmes kontrolleve.**
- ✓ **Akreditimi i drejtimeve të reja në përputhje me nevojat e tregut të punës (“smart specialisations”)**
- ✓ **Hapja e qendrave për aftësim profesional dhe krijimi i qendrave rajonale për të mbështetur arsimin joformal.**
- ✓ **Krijimi i një komiteti konsultativ për arsim fillor dhe të mesëm në nivel komunal, ku do të marrin pjesë përfaqësues të sektorit privat, qeverisjes lokale dhe shkollave fillore dhe të mesme në nivel të komunës. Ky komitet do të ndjek trendet në sektorin e arsimit dhe do të ofrojë rekomandime dhe sugjerime për politikat komunale, në lidhje me hapat, trendet dhe aktivitetet për zhvillim të infrastrukturës në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në përkufizimin e aktiviteteve shtese jashtë plan programit shkollor.**
- ✓ **Programe vjetore komunale për trajnim të arsimtarëve. Temat do të përcaktohen çdo vit në përputhje me rezultatet e fituara nga vlerësimet dhe studimi që do të bëhet në nivel komunal.**
- ✓ **Çmime dhe mirënjohje për arsimtarë të dalluar. Komuna do të riafirmojë profesionin e arsimtarit duke ndarë çdo vit çmime për arritje në kategori të ndryshme për arsimtarët e shkollave fillore dhe të mesme. Komuna në fund të çdo viti shkollor, do të krijojë listën me 20 arsimtarët e dalluar. Këta arsimtarë do të jenë fytyra e arsimit në nivel komunal për atë vit dhe promovues të vlerave të procesit arsimor. Portretet e tyre do të ekspozohen në një mur të godinës komunale që do të jetë i dedikuar për arsimtarët e vitit.**
- ✓ **Vlerësimi i jashtëm për çdo shkollë komunale, me qëllim që të standardizohen proceset administrative dhe të zbatohen standardet ISO në çdo shkollë.**
- ✓ **Krijimi i së paku një ndërmarrje në çdo shkollë të mesme profesionale, e cila ofron shërbime apo produkte të caktuara.**
- ✓ **Hapja e klasave për qëndrim tërë ditë të nxënësve deri në klasën e katërt.**



- ✓ **Vizita vjetore mjekësore në të gjitha nivelet e arsimit komunal.**
- ✓ **Angazhimi i një orto pedagogu përgjegjës për zbulimin, në parashkollore dhe në shkollë fillore, të vështirësive dhe çrregullimeve në të mësuarit tek fëmijët.**
- ✓ **Rritja e inkluzivitetit për nxënësit me nevoja të veçanta.** Ligji për arsim fillor ngërthen masa për inkluzivitet të nxënësve me nevoja të veçanta, por të cilat janë të porealizueshme në praktikë, sepse mungojnë hapësirat dhe kuadri. Do të identifikohen shkollat ku mund të realizohet inkluziviteti progresiv dhe masat e tjera që duhet të ndërmerren që këta nxënës ta ndjekin mësimin.
- ✓ **Rishqyrtimi i alokimit të donacioneve qendrore për arsim.** Sistemi aktual i donacioneve nga Ministria e arsimit dhe shkencës, i bazuar në kapitacion (për kokë nxënësi) është i padrejtë dhe diskriminues sepse nuk merr parasysh profilin sociologjik dhe gjeografik të komunave. Për shembull, komunat rurale dhe ato urbane me numër të madh fshatrash shpenzojnë buxhet të konsiderueshëm çdo vit për të përmbushur obligimin e tyre ligjor për transport të organizuar komunal të nxënësve që jetojnë më larg se 2 kilometra nga shkolla e tyre. Komunat ekskluzivisht urbane nuk e kanë këtë barrë, ndërsa përfitojnë donacione qendrore në të njëjtin nivel me tjerat. Do të angazhohemi për rishqyrtimin e këtij financimi diskriminues, duke kërkuar që të merren parasysh shpenzimet efektive të komunave për transport të organizuar të nxënësve. Ne, do të angazhohemi të ndryshojmë sistemin aktual dhe do të kërkojmë nga organet shtetërore krijimin e një modeli të drejtë dhe funksional.
- ✓ **Krijimi i kuzhinave qendrore komunale ose ndër-komunale,** aty ku është e mundur dhe bazuar në përvojat rajonale, të cilat do të punojë me fruta dhe perime lokale dhe të stinës, si dhe produkte organike për të promovuar një dietë të shëndetshme të nxënësit e shkollave fillore.
- ✓ **Shpërndarja në çerdhe dhe shkolla fillore të një shujte ditore falas,** përfshirë supë dhe ushqim të shëndetshëm, siç janë frutat dhe perimet lokale dhe të stinës.
- ✓ **Shkolla ekologjike.** Përfshirja e çerdheve dhe shkollave në programet komunale për kursim të energjisë, klasifikim të mbeturinave dhe mbrojtje të mjedisit, në bashkëpunim me ndërmarrjet përgjegjëse dhe zyrën komunale për energji.
- ✓ **Një mjedis më i shëndoshë arsimor.** Do të zbatojmë projekte vjetore tematike rreth demokracisë (vizita në institucione), qytetarisë aktive dhe jetës në shoqëri. Gjithashtu do të zbatojmë projekte të edukimit për ruajtje të mjedisit siç janë kopshtet shkollore, me fokus të veçantë në shkollat urbane. Do të promovojmë një politike edukative dhe parandaluese sa i përket përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës, si dhe edukimit të nxënësve në lidhje me bullizmin, dhunën psikike dhe përdorimin e internetit dhe rreziqet e tij.
- ✓ **Inkurajimi i krijimit të shoqatave të prindërve dhe përfshirja e tyre në projektet arsimore komunale si dhe në jetën shoqërore të lagjes dhe fshatit.** Shoqatat e prindërve do të jenë bashkëbisedues të privilegjuar të autoriteteve shkollore në menaxhimin e aktiviteteve arsimore dhe jashtë shkollore. Ato do të përkrahen nga autoritetet shkollore duke u siguruar infrastrukturën dhe pajisjet e nevojshme për të kryer misionet e tyre, duke ndarë me to dokumentet dhe vendimet kryesore rreth menaxhimit të shkollave, si dhe duke i përfshirë në organizimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore të shkollave.

## **Mbrojtje sociale dhe politikat inkluzive**

Emergjenca sociale me të cilën po përballemi si shtet, e cila është thelluar edhe më tej nga pandemia Kovid-19, kërkon një reagim politik të fortë dhe të menjëhershëm për t'iu përgjigjur shqetësimeve të qytetarëve tanë rreth papunësisë, varfërisë dhe pabarazisë.

Ndryshe, vendi do të zbrazet dhe pabarazia e lartë do të çojë pashmangshëm drejt shkatërrimit të përhershëm të besimit në institucionet e shtetit, duke krijuar kushte të favorshme për rritjen e popullzimit dhe të de stabilizimit social dhe politik.

Ne angazhohemi për politika sociale që synojnë integrimin social dhe profesional të përfituesve të beneficioneve sociale. Ne besojmë se secila komunë duhet të jetë e lirë të zhvillojë shërbimet e saj sociale në përputhje me nevojat e popullatës së saj, veçanërisht sa i përket të moshuarve, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Do të planifikojmë politika gjithëpërfshirëse por edhe politika për kategori të veçanta sociale, në bashkëpunim me sektorin joqeveritar.

### **Në këtë rrafsh, propozimet tona janë si në vijim.**

- ✓ **Sigurimi i hapësirave adekuate për shoqatat e personave me nevoja ndryshe.**
- ✓ **Sigurimi i pajisjes sinjalizuese (akustike) të semaforëve për personat me shikim të dëmtuar**
- ✓ **Vendosja e shtigjeve për persona me shikim të dëmtuar në vendet më frekvente të qytetit**
- ✓ **Krijimi i zonave të reja për këmbësore me qasje për personat me aftësi ndryshe**
  
- ✓ **Promovimi i integritimit socio-profesional të personave me aftësi të kufizuara dhe ndërmarrja e masave për të promovuar autonominë e tyre, në veçanti duke mbështetur iniciativa lokale për të krijuar infrastrukturë dhe banim kolektiv gjithëpërfshirës.**
  
- ✓ **Qasje e lehtësuar në objektet në pronësi dhe menaxhim të komunës për njerëzit me lëvizshmëri të reduktuar, duke krijuar një regjistër të përhershëm të qasshmërisë së objekteve dhe duke bashkëpunuar me ekspertë të kësaj fushe.**
  
- ✓ **Zbatimi i projekteve gjithëpërfshirëse në shkollat dhe çerdhet komunale, për të promovuar përfshirjen në shoqëri të fëmijëve me aftësi të kufizuara ose me vështirësi në të mësuar, shoqëruar me edukim të fëmijëve rreth pranimit të dallimeve dhe tolerancës.**
  
- ✓ **Qendër për autizëm e cila është në ndërtim e sipër në Komunën e Gostivarit ku fëmijët me autizëm do të kenë mundësi që të marrin terapitë e nevojshme dhe prindërit do të kenë**

mundësi të këshillohen me terapistë por edhe me prindër të tjerë.

✓ **Zhvillimi i shërbimeve për të moshuarit, përfshirë ndërtimi i një shtëpie për të moshuarit dhe i një qendre ditore për të moshuarit në Gostivar**, me vëmendje të veçantë për shërbimet që synojnë mbajtjen e të moshuarve në shtëpi, aktivitetin sportiv dhe zhvillimin e qendrave ditore për kujdes mjekësor dhe shoqërim. Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet të moshuarve me aftësi të kufizuara, duke hapur një qendër në komunën tonë për nevojat e këtyre personave.

✓ **Inkurajimi i krijimit të restoranteve sociale dhe shitoreve sociale**, Dava, një nga kuzhinat sociale e mbështetur nga Komuna e Gostivarit është mjaftë funksionale në qytetin tonë, por ne si subjekt politik e shohim mjaft të nevojshëm bashkëpunim me aktorët ekonomik (shitore, tregje, etj.) dhe shoqërinë civile, me fokus të veçantë në gupet e rrezikuara sociale për hapjen dhe krijimin e kuzhinave dhe restoranteve sociale.

✓ **Krijimi i bordeve / këshillave konsultative për të moshuarit**, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, mendimi i të cilëve do të dëgjohet para çdo iniciative relevante brenda kompetencave komunale.

✓ **Investimi në ndërtimin e kapaciteteve të reja për strehimin e personave në rrezik shoqëror**, përfshirë viktimat e dhunës seksuale, dhunës në baza gjinore dhe viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në komunën tonë.

✓ **Qendra për kujdes dhe ndihmë për personat e varur nga substancat narkotike dhe alkooli.**

## **Kultura**

Diversiteti kulturor është një nga vlerat themelore evropiane dhe luan rol thelbësor në kultivimin dhe ruajtjen e dialogut, barazisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Larmia kulturore e Maqedonisë së Veriut është dhe duhet të jetë një nga forcat kryesore të vendit. Një vend i cili ka për synim strategjik integrimin në BE, ku motoja kryesore është “të bashkuar në diversitet”, nuk guxon t'i shtypë identitetet e ndryshme kulturore përmes politikave shoviniste dhe segregacioniste, siç ka qenë rasti në gjithë historinë e ndërtimit të shtetit.

Komunat e Gostivarit për shkak të afërsisë dhe interaktivitetit që ka pas me qytetarët, ka luajtur rolin kryesor në ruajtjen e interkulturalizmit, valorizimin e identiteteve kulturore të të gjitha bashkësive, mbrojtjen dhe promovimin e hapësirave kulturore. Gjatë katër viteve të qeverisjes për çdo vit, Programit për aktivitetet e Komunës së Gostivarit nga sfera e kulturës dhe financimit të tyre i është kushtuar një rëndësi e posaçme, me qëllim të përmbushjes së objektivave specifike që do të rrisin zhvillimin kulturor të Komunës së Gostivarit dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe shumëllojshmërisë etnike. Qëllimi i gjithë kësaj është, të krijohen kushte për jetë të begatshme, cilësore kulturore, në nivel të komunës së Gostivarit, nxitje dhe afirmim i krijimit të artistëve të rinj në të gjitha sferat e jetës kulturore. Përkrahje dhe promovim të projekteve dhe programeve të cilat janë në hap me trendin kulturor evropian dhe botëror. Sigurim të vazhdimësisë së manifestimeve tradicionale kulturore të cilat janë me karakter lokal dhe ndërkombëtar, si dhe kremtimi dhe afirmimi i datave dhe personave të rëndësishëm për historinë dhe kulturën e tyre. Aktivitete të cilat janë në funksion të stimulimit dhe rimëkëmbjes të artizanaleve dhe shkathësive tradicionale dhe promovim të vendeve të vjetra në qytet. Në kuadër të të gjitha qëllimeve të sipërpërmendura dhe projekteve

konkrete të mbështetura dhe realizuara nga Komuna e Gostivarit si, “Vera Kulturore” “Mirë se vini mërgimtar”, “The park festival”, “Festivali i filmit”, nuk ka munguar as përkrahja e vazhdueshme e artistëve të qytetit, manifestimi i të gjithë datave të rëndësishme të nacionalitetit maqedonas, turk dhe rom, mbështetja e vazhdueshme e shoqërive artistike kulturore, etj.

**Ne parashohim këto prioritete që do ti realizojmë nëpërmjet këtyre masave:**

**Promovimi dhe afirmimi i vlerave artistike kulturore, përkrahja e projekteve me vlerë kulturore dhe krijimi i vlerave kulturore** do të jenë nga prioritet për mandatin e ardhshëm dhe jo vetëm duke u munduar që të arrijmë edhe:

- ✓ **Decentralizimi i institucioneve kulturore.** Do të angazhohemi për krijimin e sektorëve të veçantë për secilën bashkësi etnike brenda Ministrisë së kulturës dhe për kalimin e shumë institucioneve kulturore nën ombrellën e komunave, duke siguruar buxhet adekuat për këto institucione përmes ndarjes së buxheteve adekuate për kulturën e bashkësive etnike dhe të komunave.
- ✓ **Krijimi i Bashkësisë së komunave ku gjuha shqipe është zyrtare,** si nismë ndër-komunale që do ta ketë mision kryesor bashkërendimin e aktiviteteve vendore nga fusha e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve, si dhe e nismave rajonale të iniciuara nga bashkësitë e komunave në Shqipëri dhe Kosovë.
- ✓ **Kujdesi për objektet e trashëgimisë kulturore.**
- ✓ **Stimulimi i aktiviteteve lidhur me artin dhe edukimin artistik në shkolla, për zhvillimin e punës krijuese dhe mendimit kritik.**
- ✓ **Shpërndarje e kuponëve kulturor për të rinjtë dhe studentët, për të siguruar hyrje falas në ngjarjet kulturore komunale.**
- ✓ **Krijimi i hapësirave të strehimit për artistët dhe i hapësirave bashkëpunuese kulturore publike ose në partneritet me sektorin privat.**
- ✓ **Vënia në pah dhe valorizimi i trashëgimisë komunale, për shembull duke organizuar shtigje kulturore, në bashkëpunim me shoqatat kulturore.**
- ✓ **Qendra kulturore të komunave tona në vende të treta ku jeton numri më i madh i mërgimtarëve nga komuna, për shembull, qendra kulturore e Gostivarit në Cyrih të Zvicrës.**

## **Sporti**

Praktika e sportit duhet të inkurajohet nga aktorët komunal si në aspektin e ofertës sportive ashtu edhe të infrastrukturës. Gjithashtu të rëndësishme janë edhe aspektet që kanë të bëjnë me uljen e kostos së regjistrimit në klube sportive.

Rinia është ndër pasuritë kryesore të vendit dhe të komunave. Rritja dhe përgatitja e rinisë do të jetë një ndër objektivat tona kryesore duke siguruar zgjidhje të qëndrueshme të infrastrukturës

sportive dhe financimin e ekipeve sportive. Për këtë arsye si komunë jemi kujdes për infrastrukturë sportive cilësore për të gjithë nxënësit, ku në bashkërenditje me autoritetet qendrore dhe përmes bashkëpunimeve ndër-komunale, si dhe me mbështetjen e USAID realizuam renovimin e sallave sportive në Sh.F.K “Bashkimi”, Sh.M.T.K “Gostivari dhe Sh.F.K “Faik Konica”, Debresh. Me këtë u mundësua që të gjithë nxënësit e këtyre shkollave të kenë qasje në salla sportive bashkëkohore dhe me pajisjet e nevojshme për praktikën e sportit. Po ashtu ndërtoam stadium sportiv në fshatin Çegran, Çajlë e Vjetër dhe Debresh. Bursa për sportistët e rinj të suksesshëm dhe mbështetje financiare për sportistët e nivelit të lartë kanë qenë dhe do të jenë prioritet i jonë. Komuna shpërbleu me bursa 12 mujore në vlerë prej 3000 denarë, 10 sportistët më të mirë të rinj të qytetit të përzgjedhur nga të gjitha sportet më eminente që zhvillohen në komunën e Gostivarit.

**Ne si Aleancë për Shqiptarët në Komunën e Gostivarit për fushën e sportit e shohim mjaftë të arsyeshme vënien e këtyre prioriteteve:**

- ✓ **Sallat sportive do të përkrahin aktivitetet e klubeve sportive**, aktivitetet rekreative dhe ato garuese. Çdo sallë sportive e menaxhuar nga komuna do të përkrah aktivitetet sportive në nivel të komunës pa kompensim financiar, me çka do të stimulojmë më shumë sportin dhe aktivitetet sportive si dhe organizimin e ngjarjeve, garave sportive dhe rekreative lokale dhe rajonale.
- ✓ **Shkolla të mesme për sport në çdo komunë.**
- ✓ **Rritja e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive.**
- ✓ **Ndërtimi i shtigjeve në ambiente ekologjiksht të pastra.**
- ✓ **Stimulimi dhe mbështetja e garave sportive shkollore.** Do të stimulohet krijimi i ligave sportive shkollore në nivelin komunal dhe rajonal, në sportet kryesore të praktikuar në shkollë (futboll, basketboll, atletikë, gjimnastikë, etj.).
- ✓ **5000 metra shtigje për biçikleta dhe mbi 1000 metra katror shtigje të reja për këmbësorë janë në shfrytëzim nga qytetarët e Gostivarit. Për ne është shumë e arsyeshme të vazhdojmë me ndërtimin e shtigjeve për biçikleta dhe këmbësorë në të gjithë territorin e komunës edhe gjatë mandatit të ardhshëm.**

**Komuna me zhvillim të qëndrueshëm lokal**

**Zhvillimi i ekonomisë lokale dhe i punësimit**

Shëndeti ekonomik i një komune ose rajoni matet për nga krijimi dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Nëse i forcojmë NVM-të, do ta shtojmë dinamikën e rritjes ekonomike lokale. Por qasja ndaj zhvillimit ekonomik komunal duhet t'u përshtatet karakteristikave socio-ekonomike dhe demografike të komunës dhe rajonit planor. Mobiliteti, politika tatimore, mbrojtja e mjedisit, planifikimi hapësinor janë vetëm disa nga faktorët që ndikojnë në dinamikën ekonomike dhe tregtare të një komune.

Ne jemi të përkushtuar për fuqizimin dhe zhvillimin e NVM-ve, përmirësimin e kushteve dhe rrethanave për krijimin e ndërmarrjeve të reja, dhe mbështetjen e bizneseve lokale. Në

bashkëpunim me ekspertët, sektorin e biznesit si dhe organizata të ndryshme, do të krijojmë kushte edhe për tërheqjen e investimeve të huaja, përfshirë nga diaspora, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm lokal si dhe vende të reja pune.

Veç kësaj, komunat duhet të inkurajojnë, udhëzojnë dhe orientojnë qytetarët në kërkimin e një vendi pune, por gjithashtu të zhvillojnë bashkëpunime me organizata të ndryshme qendrore siç është Agjencia e Shërbimit të Punësimit, odat ekonomike vendore dhe të huaja, si dhe institucionet e arsimit profesional, në mënyrë që të inkurajojnë qytetarët që të orientohen drejt vendeve të punës deficitare ose aftësimi profesional.

Mundësia e menaxhimit me komunën e Gostivarit në katër vitet e kaluara, ofron mundësi të planifikimit të zhvillimit ekonomik lokal në përputhje me nevojat reale të qytetit, hartimin e politikës efikase, si dhe përcaktimin e përparësive zhvillimore lokale.

Me qëllim të zhvillimit sa më të madh lokal në komunën e Gostivarit planifikojmë përcaktimin e dy lokaliteteve për zona të lira ekonomike, edhe atë: lokalitetit “Rudina” në fshatin Çegran dhe lokalitetit “Ish Kazemat” e qytetit të Gostivarit.

Në lokacionet e sipërpërmendura do të sigurohen të gjitha kushtet infrastrukturore, përfshi rrugë, ujë, rrymë dhe kanalizim për të gjithë investitorët e interesuar.

Do të udhëheqim politikë efikase zhvillimore lokale, duke përkrahur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në mandatin që lamë pas së bashku me këshillin komunal zvogëluam taksat komunale ndërsa në mandatin e ardhshëm do ti propozojmë Këshillit komunal ulje edhe më të madhe të taksave komunale, duke stimuluar themelimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe në këtë drejtim rritjen e punësimit.

Udhëheqja me politikën ekonomike do të jetë e orientuar në rritjen e punësimit, veçanërisht duke përcaktuar përparësitë zhvillimore që prekin grup moshat e reja dhe të mesme.

### **Në këtë rrafsh, propozimet tona janë:**

✓ **Miratimi i një Plani zhvillimor komunal, që synon zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, mjedisor dhe të barabartë shoqëror.**

✓ **Programe trajnimi dhe mbështetje të NVM-ve për tregti online (“e-commerce”).** Aktualisht, vetëm 3% të NVM-ve në vend shesin produktet e tyre online, që është niveli më i ulët në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të Qendrës për Transformim Digjital do të krijohet mekanizëm i veçantë që do të mundësojë këtë trajnim.

✓ **Krijimi i zyrës së ekonomisë lokale në çdo komunë ose në nivel ndër-komunal,** për të mbështetur individualisht NVM-të dhe sipërmarrësit lokalë përmes ofrimit të shërbimeve specifike siç janë këshillimi ligjor, përgatitja e një plani financiar, kërkimi i financimeve, vënia në dispozicion të lokaleve me qira të moderuara, etj.

✓ **Qendra rinore e resurseve (QRR) në komunën e Gostivarit.** Komuna e Gostivarit disponon me qendrën rinore ICAN –investim për fuqizimin dhe trajnimin e të rinjve e cila ka si synim të jetë një model, që në një vend do ti bashkojë komunën, OJQ-të lokale dhe faktorët e tjerë kyç në bashkësinë në Këshill të përbashkët drejtues që do të udhëheq me programin dhe shërbimet, me qëllim për të zgjidhur papunësinë e lartë të të rinjtë në rajon dhe problemin me imigrimin e të rinjve, të cilët e braktisin rajonin dhe vendin. Kjo qendër rinore ofron edhe

trajtime të rëndësishme që do të ndërtojnë kompetenca kyçe për vendet e punës që u nevojiten kompanive. Pas suksesit të treguar me qendrën ICAN edhe në qeverisjen e ardhshme do të kujdesemi për investime për fuqizimin dhe trajnimin e të rinjve.

✓ **“Fshatra inteligjente”**. "Smart villages" është koncept relativisht i ri në kuadër të politikave evropiane për zhvillim rural, përmes së cilit fermerëve u mundësohet qasje dhe aftësim në përdorimin e teknologjive informatike me qëllim të zhvillimit të zonave rurale. Ky koncept u mundëson bizneseve rurale që të zhvillojnë modele të reja të biznesit dhe të lidhen dhe bashkëpunojnë më mirë me bizneset urbane. Do të zbatojmë projekte për fshatra inteligjente në komunat rurale të vendit, kjo si ndihmesë për fermerët për t'i promovuar produktet lokale, turizmin rural, si dhe aktivitetet kulturore rurale, gjë që do të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të agrobiznesit, rritjen e eksportit dhe zhvillim ekonomik. Po ashtu do punojmë në krijimin e fermave eksperimentale, të cilat do të jenë në shërbim të fermerëve dhe shkollave profesionale për trajnim dhe inovacion.

✓ **Do të kërkojmë hapjen e zyrave lokale të Ministrisë së Bujqësisë në komunat rurale në lokacionet ku mungojnë, për një shërbim më të afërt me nevojat e bujqve.**

✓ **Promovimi dhe valorizimi i produkteve lokale, duke mbështetur prodhuesit lokal në prokurimet komunale, shujtat shkollore e të çerdheve, dhe duke u krijuar atyre kushte shtesë për të rritur cilësinë e produkteve të tyre me synim të rritjes së kapaciteteve eksportuese.**

✓ **Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve akademike për zhvillim të “research and development” në nivel të kompanive. Kjo do të mundësojë optimizimin e proceseve prodhuese dhe ngritjen e cilësisë së produkteve.**

✓ **Promovimi i zinxhirëve të shkurtra ushqimore, duke mbështetur produktet lokale në tregje dhe shitore, si dhe platformat digjitale për shitje të produkteve lokale.**

✓ **Promovimi i inovacionit dhe mësimin të teknologjive të reja, në veçanti për NVM-të, punëkërkuarit dhe të rinjtë për t'u mundësuar atyre që të bëhen aktorë në ekonominë bashkëkohore.**

✓ **Punë praktike për studentët në institucionet komunale. Çdo vit, komuna do të pranojë së paku dy praktikantë me pagesë në nivel të rrogës minimale.**

✓ **Nxitja dhe ruajtja e artizanateve.**

## **Turizmi**

Pozita e volitshme gjeografike e Komunës së Gostivarit për zhvillimin e turizmit dhe trendet e fundit të zhvillimeve komunale bazuar në strategjitë si nacionale por edhe evropiane, nxisin për marrjen e masave nga pushteti komunal për zhvillimin e turizmit duke e pa si një mundësi për rritje ekonomike në qytet por edhe mundësi ideale për rritje të investimeve dhe hapje të vendeve të reja të punës. Në territorin në të cilin shtrihet komuna janë trashëguar lokalitetet me rëndësi kulturore të cilat kultivohen dhe njëkohësisht paraqesin lokalitete turistike të cilat pasqyrojnë pjesë të së kaluarës. Rajoni i Gostivarit është i pasur me bukuri natyrore dhe origjinale të cilat paraqesin potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit. Zonat malore ofrojnë mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit dimëror, gjuetisë dhe turizmit sportiv-rekreativ. Pozicioni i përshtatshëm, Mali i thatë, Mali Bistra dhe liqeni artificial i Mavrovës, kontribuojnë

që ky rajon të bëhet një qendër e madhe turistike si gjatë verës ashtu edhe gjatë dimrit. Pasuria e pyjeve, flora dhe fauna e llojllojshme, llojet e ndryshme të kafshëve të egra dhe zogjve tërheqin numër të madh të dashamirëve të gjuetisë.

Edhe pse avancimi dhe mbështetja e turizmit hynë në qëllimet afatgjate të komunës, për arsye se duhet të planifikohet rregullim ligjor i përpunimit të tokës bujqësore, promovimi i prodhimit bujqësor dhe promovimi i zhvillimit rural, të cilat do të jenë nga detyrat që do ti kemi shumë të rëndësishme për ti realizuar në të ardhmen, ne shohim mundësit dhe burimet që mund ti përshpejtojmë në shfrytëzimin dhe përdorimin e tyre.

### **Duke u bazuar në të mirat natyrore të cilat i gëzon qyteti jonë ne propozojmë:**

- ✓ **Zhvillim të një rrjeti shtigjesh për ecje në zonat malore**
- ✓ **Sinjalizim dhe udhëzues për shtigjet për ecje në lokacionet si në vijim:**
  - Gostivar - Jellovcë;
  - Çegran - Koritë;
  - Turçan i madh - Kunovë
  
- ✓ **Sinjalizim dhe Udhëzues për shtigjet për çiklizëm në lokacionet si në vijim:**
  - Gostivar - Çajlë – Forinë – Çegran – Tumçevisht – Debresh - Gostivar;
  - Gostivar – Tullanë - Turçan i madh – Llakavicë - Sërmnovë;
  - Gostivar - Tullanë - Turçan i madh – Llakavicë – Sërmnovë – Xhenovicë - Gostivar;
  - Gostivar – Banjicë – Xhenovicë – Simnicë – Cerovë - Novo Sellë – Reçan – Vërtok – Raven – Zdunjë - Gostivar.
  
- ✓ **Rinovimi i atraksioneve turistike dhe i trashëgimisë arkitektonike komunale me interes për turistët.**
  
- ✓ **Krijimi i një ueb faqe dhe i një aplikacioni komunal që listojnë dhe promovojnë monumentet dhe hapësirat me interes turistik brenda territorit të komunës, turizmin rural, si dhe ofertën hoteliere, përfshirë bujtinat rurale.**
  
- ✓ **Zhvillimi i një rrjeti shtigjesh dhe shëtitjesh të gjelbra, malore dhe rurale, në bashkëpunim me Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sinjalizimit të shtigjeve, vendosjes së tabelave informative dhe udhëzuese për vendet turistike, përfshirë përmes teknologjive informative (scan & go).**

### **Komuna me rend dhe plan në çdo lagje**

#### **Planifikimi urban dhe rural**

Ligji për planifikim urbanistik i Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 10), varësisht nga përfshirja e planifikimit urbanistik, si dhe nga ajo nëse lënda e planifikimit është me rëndësi shtetërore ose lokale, parasheh këto lloje të planeve: 1.Plan i përgjithshëm urbanistik; 2.Plan i detajuar urbanistik; 3.Plan urbanistik për fshat; 4.Plan urbanistik për vend jashtë vendbanimi si dhe 5.Plan urbanistik për zonat dhe objektet me rëndësi shtetërore.



Në drejtim të planifikimit urban ka shumë punë për tu bërë, andaj për të gjithë ato që janë lëndë e planifikimit urbanistik të rëndësishë lokale, zotohemi që sigurisht do të fillojmë procedurat për sjellje të planeve, theks të veçantë do të ketë sjella e Planeve urbanistike për fshatrat duke mundësuar që asnjë pjesë e territorit të komunës së Gostivarit të mos ngel pa plan urbanistik dhe në këtë drejtim qytetarëve ju sigurohet infrastrukturë e kompletuar ndërsa komuna do të siguroj mjete më të mëdha nga taksat komunale.

Ne do të përqendrohemi në trajtimin e problemeve kryesore në këtë fushë, si dhe në modernizimin dhe adresimin e pabarazisë në sektorët e mobilitetit, rrugëve, infrastrukturës komunale, planifikimit hapësinor, tokës ndërtimore, urbanizmit dhe energjisë. Prioritete të veçanta do të jenë rritja e ndërlidhjes lokale dhe asaj rajonale, si dhe avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës lokale, veçanërisht sa i përket ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza.

Komunat do jetë një vend me infrastrukturë më të përparuar, duke adaptuar gjithashtu planet zhvillimore me nevojat investuese në infrastrukturë.

Ne angazhohemi gjithashtu për promovimin e trashëgimisë lokale, natyrore dhe arkitekturale, duke riorganizuar hapësirën publike në mënyrë estetike dhe të qëndrueshme.

Planifikimi hapësinor në nivelin komunal duhet të synojë ngrirjen e zgjerimit urban anarkik, në dëm të hapësirave të gjelbra, pyjeve dhe tokës bujqësore. Dendësimi i territorit do të favorizojë zhvillimin e formave të banimit më të përshtatura me sfidat mjedisore dhe nevojat dhe mundësitë financiare të familjeve të reja, që janë viktimat e para të rritjes së çmimeve të patundshmërisë.

#### **Për të arritur këto objektiva, propozojmë:**

✓ **Ujë të pijshëm, rrugë cilësore dhe kanalizime për të gjithë** vendbanimet janë nga prioritet edhe për mandatin e ardhshëm edhe pse për katër vitet e qeverisjes tonë ishin mjaftë të suksesshme në këtë drejtim, duke realizuar 40 km rrugë të asfaltuara, 60 km kanalizim, mbi 30 linja të reja ndriçimi, mbi 33 km rrjet të ri të ujësjellësit. Duke mos u mjaftuar me kaq do të vazhdojmë në këtë drejtim deri sa asnjë lagje të mos përballet me mungesë të kushteve më elementare për jetesën e përditshme, siç janë uji, dritat, asfaltimi e kanalizimi.

✓ **Miratimi i planeve të reja urbanistike me qëllim të zbatimit të normave urbanistike evropiane**, ngrirjes së zgjerimit urban anarkik, dhe ruajtjes dhe zgjerimit të hapësirave të gjelbra, pyjeve dhe tokës bujqësore.

✓ **Miratimi i udhëzimeve të qarta dhe transparente mbi politikën e lejeve të ndërtimit në çdo komunë.**

✓ **Miratimi i një plani të zhvillimit rural në çdo komunë, që synon promovimin e një arkitekture dhe një peizazhi që valorizojnë kontekstin historik lokal, mjedisin dhe banimin e qëndrueshëm.**

#### **Mobiliteti**

Vlerësojmë si domosdoshmëri promovimin e një mobiliteti bashkëkohor dhe të qëndrueshëm, ku ndarja e hapësirës publike është e ekuilibruar midis këmbësorëve, çiklistëve dhe automjeteve. Ne besojmë gjithashtu se problemi i mobilitetit nuk mund të rregullohet vetëm në nivelin e territorit komunal, por se ai duhet të adresohet në nivel ndër-komunal dhe rajonal. Ne

i kushtojmë rëndësi të veçantë mobilitetit, si mjet thelbësor i zhvillimit lokal, me pasoja të drejtpërdrejta në aktivitetin ekonomik, krijimin e hapësirave të jetesës së përbashkët për të gjithë përdoruesit dhe përmirësimin e qasjes në objekte tregtare.

### **Propozime tona janë:**

- ✓ **Regjistri i rrjetit rrugor komunal dhe rajonal.** Do të evidentojmë nevojat për ndërtimin e rrugëve të reja lokale si dhe për rehabilitimin e rrugëve ekzistuese. Ky regjistër i rrjetit rrugor komunal dhe rajonal do të jetë udhërrëfyes për punën e komunës, përfshirë mundësinë e projekteve ndër-komunale.
- ✓ **Krijimi i një regjistri të vendeve me shkallë të lartë të aksidenteve të trafikut,** në mënyrë që të definohet një plan investues specifik (ngadalësues, censorë, semaforë, rreth rrotullime, etj.).
- ✓ **Krijimi i zonave pedonale në qendër të qyteteve,** në bashkërenditje me komunitetin, dhe duke marrë parasysh ndikimin në sektorin e tregtisë dhe duke ofruar zgjidhje efektive parkimi.
- ✓ **Identifikimi i rregullt i trotuareve të dëmtuara dhe ndërhyrja e shpejtë për të sanuar gjendjen.**
- ✓ **Përmirësimi i qasshmërisë së hapësirës publike për personat me lëvizshmëri të zvogëluar** (trotuare të ulura, shtylla mbrojtëse, vendkalime për këmbësorë, ndriçim publik, etj.) dhe rezervimi i së paku 3% të vendeve të parkimit për personat me lëvizshmëri të zvogëluar.
- ✓ **Miratimi i planit të çiklizmit në komunën e Gostivarit,** edhe pse komuna e Gostivarit gëzon tash më 5000 metra shtigje të reja për çiklizëm si dhe një subvencionim prej më shumë se 300 biçikletave për qytetarët e Gostivarit të cilët i kanë në përdorim, ne e shohim shumë të arsyeshme të përfshihemi në zgjerimin e shtigjeve të biçikletave, subvencionimin e blerjes së tyre dhe bashkëpunimin me shoqatat e çiklistëve.
- ✓ **Zbatimi i sistemit të kartelës së banorit në qendrat e qyteteve që siguron parkim falas për dy vetura për ekonomi familjare brenda lagjes.**
- ✓ **Vende të rezervuara për parkim dhe mbushje për veturat elektrike.**
- ✓ **Krijimi dhe subvencionimi i vend parkimeve nëpërmjet platformës digjitale.**
- ✓ **Ndërtimi i parkingjeve me pagesë, përmes koncesioneve të hapësirës publike për sektorin privat.**

### **Banimi i qëndrueshëm dhe i përballueshëm**

Shtrengimi i rregulloreve të planifikimit urban dhe mungesa e ofertës së banimit të vogël dhe të mesëm, çon pashmangshëm në rritje të çmimeve të patundshmërisë dhe sjell pasoja tjera për mënyrën e jetesës dhe mobilitetin.

**Për të adresuar këto barriera, ne propozojmë:**

- ✓ **Promovimi i krijimit të njërive të reja banesore të adaptuara me sociologjinë e komunës, në bashkëpunim me autoritetet tjera publike dhe sektorin privat.**
- ✓ **Promovimi i projekteve të përziera të ndërtimit në kuadër të zhvillimit urban. Objektet e reja duhet të kombinojnë funksionet e banimit, tregtisë, zyrave, kulturës, duke marrë gjithashtu parasysh mobilitetin (vendet e parkimit) dhe çështjet mjedisore.**
- ✓ **Krijimi i agjencisë së patundshmërisë sociale, duke inkurajuar pronarët t'i besojnë komunës administrimin e pronës së tyre.**
- ✓ **Lehtësimi i blerjes së shtëpisë apo banesës së parë për çiftet e reja, duke i stimuluar kompanitë që t'u shesin atyre me çmime pa profit dhe duke i liruar çiftet e reja nga pagesa e tatimit në pronë për aq kohë sa ata paguajnë këste të kthimit të kredisë banesore pranë një institucioni financiar.**

## **10-të top projektet kryesore të komunës së Gostivarit, 2021-2025.**

### **1.Rikontstruimi i rrugës Beliçica**

Meqë rruga Beliçica është një ndër rrugët kryesore dhe më të frekuentuara në qytetin e Gostivarit, më se e nevojshme është që e njëjta të ri konstruktohet. Sa i përket procedurës administrative për ri konstruktimin e kësaj rruge, pothuajse kemi dokumentacion të kompletuar, andaj zotohemi që ri konstruktimi i kësaj rruge do të realizohet.

### **2.Bibloteka në parkun e qytetit**

Leximi është ushqim i trurit.

Sa më shumë dimë, aq më shumë vlejme! Për të shtuar dijen dhe vlerat tona, e në veçanti të të rinjve, planifikojmë ndërtimin e bibliotekës së re të Qytetit të Gostivarit, në parkun e qytetit, respektivisht në afërsi të amfiteatrit.

### **3. Urë mbi lumin Vardar, për persona me nevoja ndryshe.**

Në afërsi të urës për këmbësorë mbi lumin Vardar, do të ndërtojmë urë për persona me nevoja të ndryshe, për të cilin tashmë kemi projekt dokumentacion të gatshëm.

### **4. Renovimi i stadiumit të qytetit.**

Me partneritet publiko-privat do të bëjmë renovimin e tërësishëm të stadiumit të qytetit të Gostivarit, duke siguruar kushte evropiane.

### **5. Rregullimi i qendrës së qytetit dhe rritja e hapësirave të gjelbra.**

Do të bëjmë transformimin e tërësishëm të qendrës së qytetit dhe do të rrisim hapësirat e gjelbra.

### **6.Aqua Park**

Qytetarëve të komunës së Gostivarit, do të ju mundësojmë Aqua Park me të gjitha standardet evropiane.

### **7. Hapja e rrugës që lidh rrugën Vëllezërit Gjinoski me rrugën e shkollës Goce Delcev**

Do të udhëheqim procedurë për eksproprijim dhe do të mundësojmë hapjen e kësaj rruge dhe në këtë mënyrë do të lehtësojmë qarkullimin e qytetarëve dhe do të shkarkojmë komunikacionin.

**8. Kompleksi Muzeor** - Ky do të jetë një projekt që synon të transformojë qendrën e qytetit duke nxjerr në pah tre-etnitetin e tij. Në qytet do të ndërtohet sipas "Pazarit të Korçës" me referentë vet arkitektët që kanë realizuar të njëjtin projekt në Korçë, një kompleks Muzeor. Do të ketë 3 pjesë, secila do të përfaqësojë një etni përkatëse. Në pavijonin shqiptar do të shfaqet gjithçka mbi traditën dhe kulturën shqiptare, po njësoj dhe në pavijonin turk e atë maqedonas. Brenda kompleksit do të jenë të inkuorporuar edhe restorante tradicionale që do të evokojnë kulinarinë e etnive përkatëse. Kompleksi do të ketë edhe shitore artizanale që do të shërbejnë punime apo ushqime tradicionale maqedonase, turke apo shqiptare. Realizimi i një projekti të tillë gjigand do të ndryshojë njëherë e mirë jo vetëm qendrën e qytetit, por do ta transformojë Gostivarin në qytetin e parë që do të presë turistë nga e gjithë bota duke i shërbyer brenda një zone me kulturë, traditë dhe diversitet etnik. Kjo sipërmarrje e jashtëzakonshme do të hap rrugët për promovimin e turizmit rural duke e kthyer Gostivarin në një atraksion turistik gjatë gjithë vitit. Do të jemi të lumtur që do të nisim një hap të tillë i cili duke uruar që të gjejë zbatim, do ta transformojë Gostivarin rrënjësisht.

### **9. Rethore për lehtësim të komunikacionit, në hyrje të qytetit të Gostivarit.**

#### **10. Plan i ri Urbanistik për tërë territorin e komunës së Gostivarit.**

Qyteti i Gostivarit më se të domosdoshme ka sjelljen e Planit të ri Urbanistik për tërë territorin e Komunës.

#### **Do të sjellim plan urbanistik të ri si për zonat urbane po ashtu edhe për zonat rurale.**

Në pajtim me kërkesat e parashtruara nga qytetarët, në pjesë të ndryshme të qytetit por edhe nëpër zonat rurale do të ofrojmë dedikime të reja, si për Çerdhe për fëmijë, Qendra universiteti, Qendra spitalore, e të tjera.

### **Infrastruktura**

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve, domosdoshmërisht duhet të punohet në mënyrë sistematike në drejtim të përmirësimit të kushteve infrastrukturore. Me përkushtimin më të madh kemi punuar në drejtim të përmirësimit të kushteve infrastrukturore, e gjithnjë të vetëdijshëm se ka edhe shumë punë për tu bërë.

Komuna e Gostivarit ka realizuar një sërë projektesh të rëndësishme kapitale ndër të cilat 40 km rrugë të asfaltuara, 60 km kanalizim, mbi 30 linja të reja ndriçimi, mbi 33 km rrjet të ri të ujësjellësit, mbi 21 kënde lojërash, 86 ulëse të reja në parkun e qytetit, duke i kushtuar rëndësi të veçantë personave me aftësi ndryshe një pjesë e ulëseve janë të përshtatura edhe për ta.

Statuti i komunës së Gostivarit parasheh mundësinë e themelimit të Bashkësive urbane dhe Bashkësive rurale. Bazuar në këtë kemi vizituar të gjithë pjesët që përfshinë territorin e komunës së Gostivarit, për të dëgjuar kërkesat e qytetarëve.

Nga takimet që kemi realizuar në të gjithë territorin e komunës së Gostivarit edhe atë në Lagjet Begu, Dutlllok, Hekurudha, Lajthia, Mllaki, Lagjja e Re, Sahati, Tregu dhe Xhamixhidi,

kërkesat e qytetarëve drejtuar komunës së Gostivarit, kryesisht kanë të bëjnë me rritjen e hapësirave të gjelbra, kënde lojërash për fëmijë, përmirësim të infrastrukturës, asfaltim të rrugëve, kanalizim, trotuare si dhe planifikim urban të ri.

Kërkesat e qytetarëve nga zonat rurale të qytetit të komunës së Gostivarit, kanë të bëjnë me: hapjen e çerdheve të reja për fëmijë, vendosjen e këndeve për lojëra për fëmijë, ndërtimin e stadimeve të vogla, përmirësimin e kushteve infrastrukturore, asfaltimin e rrugëve, bekatonizimin e rrugicave, kanalizim, përmirësimin dhe vendosjen e linjave të reja të ndriçimit publik si dhe plane urbanistike për fshatra.

Meqë përmirësimi i infrastrukturës është obligim ynë, kërkesat e qytetarëve janë parësore andaj në vijim do të paraqesim kërkesat e qytetarëve ndaj komunës së Gostivarit të parashtruara në debatet publike dhe dëgjesat qytetare edhe atë veçmas për çdo vendbanim, në mënyrë kronologjike me anë të tabelave.

**KËRKESAT E QYTETARËVE  
DREJTUAR KOMUNËS SË GOSTIVARIT  
BASHKËSIT URBANE - LAGJE**

<b>LAGJJA BEGU</b>	
1.	Rritja e hapësirave të gjelbra.
2.	Rregullimi i trotuareve.
3.	Vendosja e këndit të lojërave te kompleksi banesor.
4.	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore.

<b>LAGJJA DUTLLOK</b>	
1.	Nikolla Teslla I-prej te Gjykata deri te hyrja e Shkollës së mesme të mjekësisë.
2.	Nikolla Teslla II-prej te hyrja e Gjimnazit deri në fund të rrugës.
3.	Asfaltimi i rrugës “Servet Bajrami”, blloku 14 .
4.	Investime te parku i qytetit.

<b>LAGJJA HEKURUDHA</b>	
1.	Asfaltimi i tre rrugëve.

<b>LAGJJA LAJTHIA</b>	
-----------------------	--

1.	Renovimi i urës për këmbësor mbi lumin Vardar.
2.	Rruga prej te Xhamia - Beliçicë.
3.	Kanalizim.
4.	Linje e re e ndriçimit publik .

<b>LAGJJA MLLAKI</b>	
1.	Kanalizim.
2.	Bekatonizimi i një rrugice.

<b>LAGJJA E RE</b>	
1.	Rritja e hapësirave të gjelbra .
2.	Çerdhe për fëmijë.
3.	Kënd lojërash.
4.	Kanalizim.
5.	Trotuar.

<b>LAGJJA SAHATI</b>	
1.	Rritja e hapësirave të gjelbra.
2.	Rregullimi i sheshit të qytetit .
3.	Kënd lojërash për fëmijë.
4.	Rritja e numrit të parkingjeve.
5.	Përmirësimi i infrastrukturës.

<b>LAGJJA TREGU</b>	
1.	Asfaltimi i rrugës Beliçica .
2.	Asfaltimi ose bekatonizimi i dy rrugicave.

**LAGJJA TULLANA**

1.	Asfaltimi ose bekonizimi i rrugicave.
2.	Përmirësimi i infrastrukturës.

**LAGJJA XHAMIXHIDI**

1.	Rritja e hapësirave të gjelbra.
2.	Përmirësimi i infrastrukturës.
3.	Kënd lojërash për fëmijë.

**ZONAT RURALE****FSHATI BANJIC E EPËRME**

1.	Përfundimi i kanalizimit.
2.	Asfaltimi i rrugës.

**FSHATI BANJIC E POSHTME**

1.	Asfaltimi i rrugës Banjicë e Poshtme - Dutllok.
2.	Asfaltim ose bekonizim i tre rrugicave.

**FSHATI BALINDOLL**

1.	Asfaltimi i dy rrugëve.
2.	Bekonizimi i tre rrugicave.
3.	Mundësia e hapjes së një çerdheje për fëmijë.
4.	Rregullimi i shtratit të lumit Vardar.
5.	Ndërtimi i filtër stacionit për ujërat e zeza.

<b>FSHATI ÇAJLË</b>	
1.	Përfundimi i kanalizimit.
2.	Zgjidhje për ujërat atmosferik.
3.	Asfaltim ose bekatonizim i disa rrugicave.
4.	Kënd lojërash për fëmijë te shkolla.
5.	Hapja e rrugës alternative mes Çajlës dhe Forinës, që lidhet me qytetin.

<b>FSHATI ÇAJLË E VJETËR</b>	
1.	Asfaltimi i katër rrugicave.

<b>FSHATI ÇEGRAN</b>	
1.	Përfundimi i kanalizimit.
2.	Rritja e kapacitetit të ujësjellësit.
3.	Shëtitoret rreth lumit Vardar, rregullim, ndriçim publik, rrethojë mbrojtëse me gjatësi afër 1 km.
4.	Përfundimi i rrugës alternative dhe asfaltimi i saj (rruga e dytë ndihmëse).
5.	Asfaltimi i rrugës nga restorant Oaza, që lidhet me rrugën Çegran - Tumçevisht.
6.	Rregullimi i vijës së Vardarit.
7.	Kujdesi për higjienën e fshatit, punësim i katër punëtorëve aktiv për mirëmbajtjen e higjienës.
8.	Urbanizimi i vendit të kampit si zonë industriale.
9.	Plan urbanistik për fshatin Çegran.
10.	Asfaltimi i pesë rrugicave që lidhen me rrugën kryesore.
11.	Përkrahje më e madhe financiare për bashkësinë lokale të fshatit Çegran.



<b>FSHATI DEBRESH</b>	
1.	Furnizimi me ujë të pijshëm.
2.	Ndërrimi i gypave të ujësjellësit.
3.	Përfundimi i kanalizimit.
4.	Asfaltimi i rrugës që lidh Debreshin me Zdujnën.
5.	Asfaltimi i një rruge në brendi të fshatit.

<b>FSHATI FORINË</b>	
1.	Rrethimi i oborrit të shkollës.
2.	Rrethimi i stacionit të ujësjellësit.
3.	Zëvendësimi i gypave plastike me gypa metalike të sistemit të ujësjellësit në pjesët e urave.
4.	Asfaltimi i katër rrugicave.
5.	Hapja e rrugës alternative që lidhë fshatin Forinë me qytetin e Gostivarit.
6.	Ndërtimi i një stadiumi te vogël.

<b>FAZANERI</b>	
1.	Kanalizim.

<b>GRUDAJCË</b>	
1.	Kanalizim.

<b>FSHATI GJENOVICË</b>	
1.	Bekatonizimi i rrugicave.

<b>FSHATI JELLOVCË</b>	
1.	Vendosja e mbrojtësve rreth rrugës.

<b>FSHATI LLAKAVIC</b>	
1.	Asfaltimi i një rruge.
2.	Hapja e rrugës së fushës Llakavicë - Turçan i Madh.
3.	Pastrimi i shtratit të lumit.

<b>FSHATI PADALISHT</b>	
1.	Bekatonizimi i dy rrugicave.
2.	Sanimi i gropave goditëse.
3.	Vazhdimi i vendosjes së anësorëve mbrojtëse në rrugë.

<b>FSHATI QAFË</b>	
1.	Bekatonizimi i rrugicave.

<b>FSHATI RAVEN</b>	
1.	Ndërtimi i dy linjave të ujësjellësit.
2.	Ndërtimi i trotuarit në njërin anë në rrugën kryesore.
3.	Asfaltim ose bekatonizim i disa rrugëve.
4.	Ri konstruktimi i rrugës në qendër të fshatit.

<b>FSHATI REÇAN</b>	
1.	Asfaltimi i rrugës Reçan - Vërtok.
2.	Asfaltimi i rrugës Reçan - Magjistrale.
3.	Kanalizim.

<b>FSHATI SËRMNOVË</b>	
1.	Ndërtimi i parkut në afërsi të shkollës fillore.
2.	Bekatonizimi i dy rrugicave.

<b>FSHATI SIMNICË</b>	
1.	Asfaltimi i rrugës te Mëhalla e epërme.

<b>FSHATI STRAJAN</b>	
1.	Bekatonizimi i rrugicave.

<b>FSHATI TËRNOVË</b>	
1.	Asfaltimi ose bekatonizimi i disa rrugicave.

<b>FSHATI TURÇAN I MADH &amp; LLAPUSHNIK</b>	
1.	Asfaltimi i dy rrugëve kryesore të fshatit.
2.	Bekatonizimi i katër rrugicave.
3.	Vendosja e ndriçimit publik në tërë territorin e fshatit.
4.	Kanalizimi të përfundohet në tërë pjesët e fshatit.
5.	Rrjet i ri i ujësjellësit në disa pjesë të fshatit.

<b>FSHATI TURÇAN I VOGËL</b>	
1.	Asfaltimi i rrugës që shpie tek varrezat e fshatit .
2.	Instalimi i ndriçimit publik.
3.	Rregullimi i çështjeve pronësore-juridike për varrezat e fshatit.
4.	Asfaltimi ose bekatonizimi i rrugës që lidhë fshatin Turçan i Vogël me fshatin Turçan i Madh.

<b>FSHATI VËRTOK</b>	
1.	Kënd për lojëra.
2.	Kanalizim.
3.	Ujë i pijshëm.

<b>FSHATI ZDUNJË</b>	
1.	Asfaltimi i rrugës kryesore.
2.	Asfaltim ose bekatonizim i disa rrugicave në brendësi të fshatit.
3.	Plan i ri urbanistik për fshatin Zdunjë.
4.	Përmirësimi i rrjetit të ujës-jellësit.
5.	Ndërtimi i trotuarit në kahje të Shkollës fillore ne Zdunjë.

Jemi gjithmonë mirënjohës e falënderues ndaj qytetarëve, në bashkëpunim me të cilët kemi identifikuar të gjitha problemet të cilat prekin qytetin dhe janë në pajtim me kërkesat reale të qytetarëve, andaj vlerësojmë se kërkesat e qytetarëve janë të bazuara dhe në pajtueshmëri me kompetencat e komunës.

Për periudhën 2021-2025, zotohemi që do të përpiqemi të realizojmë shumicën e kërkesave të parashtruara nga qytetarët, gjithnjë duke qenë të vetëdijshëm për kapacitetin që kemi si komunë për realizimin e të njëjtave.

Do të punohet në mënyrë proporcionale, duke mundësuar investime në të gjitha vendbanimet, në mënyrë që të mos ketë asnjë vendbanim pa punë të kryer.

Pasqyra e qeverisjes për periudhën 2021-2025, do të jetë realizimi i kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve. Qeverisja jonë do të jetë e barasvlershme, me aq sa kërkesa do të realizojmë, për këtë arsye do të mundohemi që të njëjtat ti realizojmë në tërësi.

Duke punuar në mënyrë sistematike, synimi ynë do të jetë që përfundimisht të eliminojmë nevojat elementare infrastrukturore dhe njëherë e përgjithmonë të mos flitet më për ujë të pijshëm dhe kanalizim.

## **BIOGRAFIA E DR.ARBEN TARAVARI**

Arben Taravari, erdhi në pozitën e Kryetarit të Komunës së Gostivarit më 02.11.2017, pasi fitoi zgjedhjet lokale më 29.10.2017.

Më 1 qershor 2017, ai u emërua ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, detyrë të cilën e ushtroi deri më 31 tetor 2017.

Dr. Arben Taravari është neurolog me përvojë shumëvjeçare në Klinikën Universitare të Neurologjisë Shkup.

U lind më 9 prill 1973 në Gostivar. Në 1998 u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Universiteti Shën Kirili dhe Metodi dhe në vitin 2006 përfundoi specializimin në fushën e neurologjisë në Klinikën Universitare të Neurologjisë. Ai përfundoi specializimin e dytë në mjekësinë familjare në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi në vitin 2011.

Në vitin 2011 ai mbrojti disertacionin e doktoratës në fushën e sëmundjes së Parkinsonit, dhe që nga viti 2010 ka qenë ligjërues i plotë në Fakultetin e Mjekësisë në Shën Kirili dhe Metodi.

Gjatë përvojës së tij të punës, Dr. Arben Taravari ishte Kryetar i Bordit të Departamentit të Sëmundjeve Extrapiramidal - Klinika Universitare e Neurologjisë; Shef i Departamentit të Migrenës, Dhimbje koke dhe Sindroma të tjera, Klinika Universitare e Neurologjisë;

Ai është Kryetar i Bordit të Klinikës së Neurologjisë, Klinikës Universitare të Neurologjisë, si dhe anëtar i bordit të revistës mjekësore "Medicus" dhe "Vox Medici".